

Lidija Pshenko

KULTURA MUZIKORE

VITI I
ARSIMI I MESËM PROFESIONAL



Lidija Pshenko

KULTURA MUZIKORE

**VITI I
ARSIMI I MESËM PROFESIONAL
KATËR VJEÇAR**

Shkup, 2022

Autorë:
Lidija Pshenko

Recensemëtë:

Prof. Dr. Tihomir Joviç, Universiteti „Sh. Kirili dhe Metodi“ në Shkup, Fakulteti për Art
Muzikorë – Shkup
Dr. Bekim Ramadani, SHMK Gjimnazi „Kiril Pejçinoviq“ – Tetovë
Anita Stankovska, SHMK „Jane Sandanski“ – Strumicë

Titulli i botimit original:

МУЗИЧКА КУЛТУРА - I ГОДИНА
Средно стручно образование

Botues:

Ministria për Arsime dhe Shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Rr. „Shën Kirili dhe Metodi“, nr. 54, 1000 Shkup

Përktheu nga gjuha maqedone:
Lek Dalipi

Lektor:
Safit Zekiri

Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe:
Dardan Braimi

Radhitja kompjuterike:
Arberia Design (Afrim Bulica)

Redaktimi kompjuterik:
Mirko Davidovski

Vendi dhe viti i botimit:
Shkup, 2022

Me vendim për miratimin dhe përdorimin e tekstit shkollor për lëndën Kulturë Muzikore për vitin e I-rë të arsimit të mesëm profesional katërvjeçar nr. 26 - 228/1, i datës 07.04.2021, miratuar nga Komisioni Nacional i Teksteve Shkolllore.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

78:37(075.3)

PSHENKO, Lidija

Kultura muzikore [Електронски извор] : viti I arsimi i mesëm profesional katër vjeçar / Lidija Pshenko ; [përktheu nga gjuha maqedone Lek Dalipi]. - Shkup : Ministria për arsim dhe shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2022

Начин на пристапување (URL):


https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Muzickakultura_%201_albanski.pdf.

- Превод на делото: Музичка култура : I година средно стручно четиригодишно образование. - Текст во ПДФ формат, содржи 95 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 17.08.2022

ISBN 978-608-273-076-9

COBISS.MK-ID 57993477

„Muzika i jep shpirt universit, krahë mendjes, fluturim imagjinatës dhe jetë gjithçkaje.“
(Platon)




„Muzika mund të emërojë të paemërtuarën dhe të shprehë të panjohurën.“
(Leonard Bernstein)



*„Betoveni ju tregon se si është të jesh Betoven, dhe Mocarti ju tregon se si është të jesh njeri.
Bahu ju tregon se si është të jesh universi.“*
(Douglas Adams)



„Muzika është ushqimi i dashurisë.“ (William Shakespeare)



TEMA MËSIMORE

• MUZIKA PËRMES HISTORISË •



• TRADITA DHE ZAKONE MUZIKORE •



„ODA E GËZIMIT“

Ode to Joy / An die Freude

Shiller/Schiller Allegro

Betoven/Beethoven

Fre- ude, schö-ner Göt-ter-fun-ken, Toch-ter aus E - ly - si-um, Wir be-tre-ten feu-er-trun-ken
 7 Himm li- sche, dein Hei - lig-thum! Dei-ne Zau-ber bin - den_ wie-der, was die_ Mo-de
 12 streng ge - teilt; al - le Men-schen wer-den Brü-der, wo dein sanf-ter Flü - gel weilt.

Gëzim ti mrekulli
 hyjnore
 Jetën tonë pérherë
 stolisë
 Në pragun tënd magji
 përrallore
 Rritet kënga rrugën nis
 Se atë që mbyt mërzia
 Ti sërish e gjallëron
 Vëllazërohet njerëzia
 Fryma jote kudo shkon.



VENDI DHE ROLI I MUZIKËS NË SHOQËRI

Muzika dhe shoqëria janë koncepte të pandashme. Nëse i kthehem parahistorisë, do të vërejmë se në artin sinkretik qëndrojnë fillimet edhe të muzikës, edhe të vallëzimit, të poezisë, letërsisë, piktures, por edhe magjisë, religjionit dhe vetë kulturës. Arti dhe shoqëria kanë një rrënje të përbashkët, ndaj nuk duhet të habitemi aspak nga rëndësia dhe ndikimi i madh i muzikës në të gjitha qytetërimet dhe përgjatë historisë.

Muzika, siç ka thënë Platoni, është po aq e mirë sa shteti në të cilën është krijuar, por mund të argumentojmë se cilësia është vetëm një nga shumë kategoritë që lidhin kuptimet dhe ndryshimet në muzikë me kulturat përkatëse në të cilat ajo shfaqet. Mund të thuhet se vetë muzika ndihmon në formimin e një shoqërie; se ajo ka qenë gjithmonë dhe mbetet, së bashku me artet e tjera, një faktor kyç në përcaktimin e gjithçkaje në një komunitet që konsiderohet e bukur, e mirë, e drejtë, e lejuar apo e ndaluar, e natyrshme apo artificiale, popullore apo e vjetërsuar. Në art qëndron fryma e një shoqërie dhe muzika, arti më abstrakt, është ndoshta ajo që e kap atë më saktë.

Gjatë historisë, muzika ngadalë është ndarë nga artet e tjera. Në antikitet u zhvillua së bashku me vallëzimin dhe poezinë. Në mesjetë, qytetërimi evropian gjeti aplikim për muzikën në ritet fetare dhe që nga Renesanca e deri në ditët e sotme, ajo është bërë e pavarur dhe zë mbi të gjitha një rol estetik në kulturë.



Kjo do të thotë se muzika stimulon krijimtarinë te njerëzit – si tek ata që e kompozojnë dhe performojnë, por edhe tek ata që e dëgjojnë. Ajo argëton dhe çliron, dhe nëse trajtohet në mënyrë analitike, mund të shihet si një set matematikor dhe teknikor, që kërkon saktësi dhe aftësi gjatë performancës. Muzika ngjall mendime dhe ndjenja shpirtërore dhe filozofike dhe i lejon njerëzit të kuptojnë më mirë veten e tyre. Ajo mund t'ju afrojë dhe t'ju gëzojë, por gjithashtu mund t'ju relaksoj. Shpesh ajo është një strehë për endrrat njerëzore.

Sipas kësaj, muzika është një mjet për komunikim. Ajo i lidh njerëzit me njëri-tjetrin, por edhe me botën në të cilën jetojnë. Në të kaluarën, stilet dhe tendencat e muzikës kanë ndryshuar ngadalë, sepse edhe shoqëritë kanë ndryshuar ngadalë. Mund të flasim për stile të caktuara muzikore që kanë zgjatur me shekuj të tarrë. Por në shekullin XIX, XX dhe veçanërisht në shekullin XXI, muzika ndryshon nga dita në ditë, janë paraqitur shumë zhanre dhe nënzhanre paralele me njëra-tjetrën. Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë është në përputhje me muzikën me ritme të shpejta dhe teknologjike që dëgjohet sot. Pavarësisht gjithçkaje, muzika vazhdon të krijohet, por gjithmonë si pasqyrë e botës dhe e kohës së saj.

Është e vërtetë që rruga e muzikës është e gjatë. Nevojitet një autor (kompozitor) dhe një artist (performues) që do ta përcjellë atë tek dëgjuesit (audiencia). Ngjarjet muzikore si koncertet, festivalet muzikore etj., përfaqësojnë më së miri këtë proces drejtpërdrejt, megjithëse, së fundmi, teknologjia lejon që ai të kapet edhe në mënyra të ndryshme. Muzika mund të interpretohet dhe riinterpretohet shumë herë, dhe kuptimi i saj mund të ndryshojë nga periudha në periudhë, nga personi në person.

PYETJE PËR DISKUTIM:

1. Shpjegoni vendin dhe rolin e muzikës në shoqëri!
2. Diskutoni ndikimin e muzikës në jetën e njerëzve!
3. Si e përjetoni dhe kuptioni muzikën?

RENESANSA

„Renaissance“ – Rilindja


Përfaqësues të rilindjes



Francesco Petrarca
(poet)



Giovanni Boccaccio
(shkrimtar, poet)



Leonardo Da Vinci
(piktor, skulptor, shkencëtar, inxhinier,
arkitekt, anatomist)



Michelangelo Buonarroti
(skulptor, piktor, arkitekt, poet)



William Shakespeare
(dramaturg, poet, aktor)

Do të mësojmë për:

- renesancën dhe muzikën e renesancës duke bërë krahasimin me veprat e artit të renesancës;
- dallimet midis muzikës laike dhe asaj shpirtërore në renesancë;
- përfaqësuesit e renesancës muzikore;
- instrumentet e renesancës.

Terme të reja:

MADRIGAL | MESHA | LAUTA | ORGANO

MUZIKA E RENESANSËS

Shekulli XV – XVI

Renesanca (rilindja) u shfaq në Itali, dhe më pas u përhap në pjesën më të madhe të qytetërimit të Evropës Perëndimore. Ndahet në renesancës e hershme (1400–1500) dhe të vonshme (1500–1600). Renesanca është një periudhë jashtëzakonisht e rëndësishme transformimi dhe rivlerësimi si në aspektin social ashtu edhe në atë artistik, e cili mbi të gjitha fokusohet në centralizimin e sekularizmit (laicizmit) kundrejt spiritualitetit (fetarizmit) deri atëherë dominues në jetën shoqërore. Zvogëlimi i ndikimit të Kishës Katolike në të rezulton në ripopullarizimin e idealeve estetike antike, e ndjekur nga kulti ndaj njeriut (si në kuptimin mental ashtu edhe fizik) dhe një kthesë drejt folklorit si një burim shtesë i shprehjes krijuarës dhe rekreative.



Sandro Botticelli (1445–1510)

La Primavera (Spring)

Aspirata e tilla, të ndihmuara nga (krahas shpikjeve të tjera shkencore) shfaqja e shtypshkronjës së parë të Gutenberg, çuan në renesancën e pashmangshme muzikore në shekullin XVI, e cila, duke u mbështetur në shtypjen e notave të para, nënkuptione lexicin e tyre dhe arsimimin bazë muzikor si pjesë të kulturës së përgjithshme. Gjithashtu, muzika gjithnjë më shumë afrohet me shtresat e mesme dhe të ulëta të popullit, dhe lozonjaria e saj botërore, e dukshme në format si madrigali, frotola, vilanella, serenata, kancona, shansona, balada e të ngjashme, dalëngadalë fillon të depërtojë edhe në kompozimet fetare. Mënyra polifonike e të shprehurit është mbizotëruese në muzikën vokale (*a cappella*) kishtare, e cila gjithashtu fillon të këndohet edhe në gjuhën popullore, dhe jo vetëm atë latine. Kjo i ndryshon përgjithmonë krijimet shpirtërore - meshat dhe motetet.

Giovanni Pierluigi da Palestrina



Giovanni Pierluigi de Palestrina (1525–1594),

është një kompozitor italian dhe një nga figurat më me ndikim në muzikë nga gjysma e dytë e shekullit të XVI-të - "epoka e artë" e muzikës kishtare. Ai lindi në qytetin e Palestrinës, emrin e të cilit e adoptoi. Në moshë shumë të re, ai u bashkua me korin e kishës papale dhe mori arsimin muzikor në shkollën Gudimel, ku fitoi një teknikë të spikatur polifonike. Fillimisht shërbeu si organist dhe mjeshtër i korit i kishës kryesore në Palestrina dhe më pas u transferua në Romë ku mbajti postet e pedagogut të këngës dhe drejtuesit të korit të fëmijëve (në Katedralen e „Shën Pjetrit“). Me ndihmën e Papës Marsel II, ai u bë këngëtar në Kapelën Sistine në Vatikan, dhe një pjesë të madhe të kohës së tij ia kushtoi kompozimit.

Shumë prej veprave të tij bazohen në melodi gregoriane, dhe teknika e tij kontrapuntore konsiderohet si e përsosur në kohën e tij, deri në atë pikë sa u quajt edhe "Princi i Muzikës". Meshat që ai shkroi (sipas burimeve të ndryshme, nga 94 në 105 në numër, të botuara në 13 libra) demonstrojnë forma të ndryshme - nga kompozime të thjeshta për katër zëra deri në cikle të plota me gjashtë ose tetë zëra. Vepra e tij më e famshme, "Mesha e Papa Marcellos", është një prej tyre. Motetat (rreth 300) janë zhanri i radhës në veprën e Palestrinës, ndërsa dy librat e tij me madrigale, psalmet dhe magnifikatet mbeten nën hijen e veprave të tjera të tij.



Orlande de Lassus

Orlando di Lasso (1532 –1594) lindi në qytetin Mons (Flanders, Belgjika veriore). Në fëmijëri lë mbresë me zërin e tij të bukur duke kënduar në koret e kishës, kurse më vonë punon në disa qytete të Evropës.

Në Romë ai u shqua si kryekapelan/ /
udhërrëfyes, dirigent i një prej katedraleve dhe
pjesën tjeter të jetës e kaloi në Mynih (Gjermani).
Autoriteti i tij në qarqet e muzikës dhe artit u rrit
gradualisht dhe fama e "Orfeut Belg" u përhap në
të gjithë Evropën.

Lasso studioi të gjitha veprat më të mira të
krijuara nga paraardhësit e tij (kompozitorë
holandezë, francezë, gjermanë dhe italianë) dhe u
përpoq të krijonte stilin e tij. Për këtë qëllim,
kompozitori ndonjëherë përdorte motive zhanri
(tema të këngëve popullore, valleve), duke
bashkuar kështu traditat kishtare dhe laike.



Echo-Song

"Ola! o che bon ecchol,"

For Double Chorus of Mixed Voices

English version by Sigmund Spaeth

Orlando di Lasso
Arranged for Concert Use by
Wilhelm Widmann
dim.

Andante

Soprano Alto Chorus Tenor Bass

Ho there! Oh hear the ech - o! Oh,what a joke!
O - là! o che bon eo-sho! Pi-glia-mo-cl
Ho there! Oh hear the ech - o! Oh,what a joke!
O - là! o che bon eo-sho! Pi-glia-mo-cl
Ho there! Oh hear the ech - o! Oh,what a joke!
O - là! o che bon eo-sho! Pi-glia-mo-cl
Andante

Soprano Alto Chorus Tenor Bass

Ho there! Oh hear the ech - o! Oh,what a
O - là! o che bon eo-sho! Pi-gliamo -
Ho there! Oh hear the ech - o! Oh,what a
O - là! o che bon eo-sho! Pi-gliamo -
Ho there! Oh hear the ech - o! Oh,what a
O - là! o che bon eo-sho! Pi-gliamo -
Ho there! Oh hear the ech - o! Oh,what a
O - là! o che bon eo-sho! Pi-gliamo -

Hej ti!
sa jehone e bukur!
le ta provojmë.
Më vjen mirë që u
njohem!
Ha ha ha ha,
le të qeshim të gjithë!
O shoku im i mirë?
çfarë dëshironi?
Unë do të doja që ju të
këndoni
një
këngë
Pse?
Pse duhet?
Pse jo?
Sepse nuk dua.
Pse nuk dëshironi?
Sepse nuk më pëlqen!

Teknika polifonike e Lasso-s ishte mjeshtërorë dhe komplekse dhe ai ishte veçanërisht i suksesshëm në madrigale, bazuar në vargjet e Petrarkës, Tasos, Transilos dhe poetëve të tjerë italianë, të cilët përpunonin psikologjinë e personazheve të tyre. Një nga veprat e tij më të njohura është vilanellëserenata "Matona mia cara" ("Zonja ime e dashur") për një kor katër-zérash, e shkruar në italisht, me përbajtje dashurie, e kompozuar në vitin 1581.

ORLANDO.

The manuscript page features a large, ornate initial 'M' on the left. Above the 'M' is the title 'ORLANDO'. Below the 'M' are four staves of music. The lyrics are written below each staff in Italian. The first staff has lyrics: 'Atora mia carami follere canzon Matona.' The second staff has lyrics: 'tar sotto finestra Lantze buò còpagnon Dô dô don diri diri don don don dô Don.' The third staff has lyrics: 'Tiprego m'ascoltare che mi cantar de bon Ti. che.' The fourth staff has lyrics: 'E mi tifoller bene come greco e capon Dô dô don diri diri don don don dô Don.' The fifth staff has lyrics: 'Com'andar ale cazzecazzar cazzar con le falcon Co. cazzar. Mi'

Lasso i përket grupit të kompozitorëve më produktiv të të gjitha kohërave: numri i veprave të tij është mbi 2000, nga të cilat 530 motete, 175 madrigalë dhe villanelë italianë, 150 shansona franceze, 90 këngë dashurie gjermanë 'lieder' dhe 60 mesha, si dhe të tjera.



KRIJIMET BOTËRORE

- **Madrigal** – një formë polifonike në të cilën gjithnjë e më shumë i jepet përparësi linjës më të lartë melodike, ndërsa linjat e tjera melodike e ndjekin atë konsonantet akordike. Ai përmban veçori të forta realiste në fjalimin muzikor dhe një sërë tematikash. Në fillim ai shfaqet vetëm si vokal, e më vonë merr një shoqërim instrumental. Ka origjinë nga Italia.
- **Vilanela** – këngë barinjsh me tematikë komike, satirike ose parodi.
- **Serenatë** – kompozim italian i lehtë, i qetë, i realizuar për nder të një njeriu të dashur, mikut, personit të shquar ose një ngjarje të caktuar. Zakonisht është me përbajtje dashurie dhe interpretohet në mbrëmje, në një atmosferë intime, nga një burrë, i shoqëruar nga një instrument me tela (kitarë, lahatë, mandolinë).
- **Shansonë** – vepër vokale dhe vokalo-instrumentale me temë dashurie. Ka origjinë nga Franca.
- **Frotola** – këngë e thjeshtë, e realizuar zakonisht me tre deri në katër zëra, me një linjë kryesore melodike. Konsiderohet si një pararendës i madrigalit.



KRIJIMET SHPIRTËRORE

- **Meshë** – pjesë qendrore e shërbesës të krishterë perëndimore (katolike), vepër muzikore që është e pranishme në të gjitha epokat dhe është polifonike.
- **Motet** – një kompozim koral polifonike ‘a cappella’ e shkruar në tekstrit latin (zakonisht nga Bibla), bazuar në parimin e imitimit.

Përveç rritjes së muzikës vokale, a cappella (vetëm performanca korale), e cila është lloji bazë i muzikës së renesancës, gjithsesi zhvillohet edhe muzika instrumentale, me dominimin e instrumenteve frysore, me goditje dhe paraardhësve të violinës (viola da bracha) dhe violonçelës (viola da gamba).



Viola da bracha



Viola da gamba

- **Lahuta** - një instrument muzikor me tela me origjinë orientale, i cili fiton popullaritet si një instrument shoqërues ose solo. Në fillim ka 11 tela, dhe më pas në shekullin e XVI-të, numri i tyre u rrit në 24.



- **Instrumentet frysore** – organoja – aerofon, nga më të mëdhenjtë, karakteristik për muzikën shpirtërore. Tingulli prodhohet nga rrjedha e ajrit nëpër tuba të madhësive të ndryshme dhe duke shtypur tastet e shumicës së pianove, të cilat janë të renditura gradualisht. Dikur ishte karakteristikë e katedraleve, por më vonë u përfshi në disa nga sallat më të mëdha të koncerteve.



Test për njohuritë:

1. Rendisni veçoritë themelore të muzikës së renesancës!
2. Shpjegoni arsyet e shfaqjes së muzikës shpirtërore dhe botërore!
3. Jepni një pasqyrë të shkurtër të jetës dhe veprave të G. P. de Palestrina dhe O. di Lasso!

Dëgjimi i muzikës:

Giovanni Pierluigi de Palestrina "Mesha e Papa Marçelos" - fragmente të Orlando di Lasso "Zonja ime e dashur" Orlando di Lasso "Echo".

BAROK


Përfaqësuesit e barokut



William Harvey
(mjek)



Isaac Newton
(fizicient, matematikan, astronom, alkimist)



Benjamin Franklin
(burrë shteti, filozof, fizikan, ekonomist dhe shkrimtar)



Diego Velázquez
(piktor)



Rembrandt Harmenszoon van Rijn
(piktor)



Jean-Baptiste Poquelin – Molière
(shkrimtar)



Jean de La Fontaine
(shkrimtar)



Daniel Defoe
(shkrimtar)

MUZIKA NË BAROK

Do të mësojmë për:

- barokun dhe barokun muzikor;
- përfaqësuesit e muzikës barok;
- Jeta dhe vepra e Johann Sebastian Bach dhe Georg Friedrich Handel.

Terme të reja:

FUGA | ORATORIUM | ÇEMBALO | VIOLINA

Barok – barroco (portugalisht), **barrueco** (spanjisht) është një fjalë që do të thotë e pasaktë, perlë e papërpunuar, i cili përdorej në një konotacion negativ - me të përshkruheshin vepra arti të ekzagjeruara, artificiale. Më vonë, termi barok filloj t'i referohej ndjeshmërisë artistike të dekoruar dhe të punuar me mjeshtëri të cilën e trashëgoi Renesanca. Ai dominoi, mbi të gjitha, në arkitekturë dhe arte figurative dhe besohet se N. A. Plushe dhe J. J. Rousseau ishin të parët që e përdorën termin në shekullin e XVIII-të për të përshkruar një stil të veçantë muzikor.

Kufijtë e muzikës barok janë mjaft të paqarta – si fillim llogaritet ose viti i vdekjes së Palestrinas dhe Lasso (1594) ose viti kur u shfaq opera e parë (1598), ndërsa si fundi i barokut konsiderohet viti i vdekjes së Bach-ut (1750). Sipas Hugo Riemann, muzika barok zgjati nga viti 1600 deri në 1750, dhe sipas Manfred Bukofzer nga 1580 deri në 1730, dhe ai ndahet në tre periudha.

BAROK	I HERSHËM	I MESËM	I VONSHËM
Periudha kohore	1580-1630	1630-1680	1680-1730
Përfaqësues	Claudio Monteverdi	Antonio Vivaldi	J.S. Bach G.F. Handel
Forma muzikore	Monodia Opera	Suita Sonata Koncert	Oratorium Kantata Fuga Sonata Koncert
Karakteri	LUKS – MADHËSHTI – SHKËLQIM – ZBUKURIM		

Kalimi nga shekulli XVI në shekullin XVII njihet si një moment historik i madh në historinë e muzikës, sepse sjell me vete ndryshime në melodi, harmoni, ritëm, instrumente, forma muzikore e të ngjashme.

Një nga pikat e kthesës, që simbolizon fillimin e barokut muzikor, është shfaqja e operës, një vepër muzikore-skenike në të cilën bashkohen disa dukuri artistike.

KOMPOZITORI	OPERA	VITI	OPERA E PARË
JACOPO PERI	“DAFNE”	1597	Pres së cilës janë ruajtur vetëm dy fragmente
JACOPO PERI	“EURIDICA”	1600	Opera e parë e rujatur
CLAUDIO MONTEVERDI	“L’ORFEO”	1607	Opera e parë e rëndësishme



Gjithnjë e më shumë përdoren tonet dur dhe mol, të cilat zëvendësojnë plotësisht modalitetet e Renesancës, linjat melodike mbizotërohen nga akordet e zbërthyera, zgjerohet diapazoni i zërave, bie në sy trajtimi i lirë i disonancës, shfaqen kromatika, dekorimet (trillerat) etj. Ritmi pulson vazhdimisht, me motorikë dhe me vlera notash të shkurtra, dhe polifonia arrin kulmin, sidomos me teknikën ‘punctus contra punctum’ (teknikë kompozicionale në të cilën dy ose më shumë linja melodike (ose “zëra”) plotësojnë njëra-tjetrën, por veprojnë në mënyrë të pavarur) tek kanoni, invencioni dhe fuga.

Me paraqitjen e solistëve vokalë dhe instrumentalë, individi del në ballë të ansamblit, për të vënë në shprehje virtuozitetin e tij. Instrumentet perfeksionohen dhe gjithnjë e më shumë kompozohet muzikë instrumentale. Nga këto instrumente me tastierë, dominon çembaloja, e cila i paraprin pianos. Familjet Stradivari, Amati dhe Guarneri janë një nga prodhuesit më të njojur të instrumenteve me tela.

Format muzikore më të zakonshme në periudhën barok janë:						
Vokale dhe vokalo-instrumentale	opera	kantata	oratorium	mesha	pasia	fuga
Instrumentale	fuga	suita	koncert solistik	preludium	tokata	pasakalia

Përfaqësuesit më të famshëm të muzikës barok



Claudio Monteverdi



Arcangelo Corelli



Jean-Baptiste Lully



Henry Purcell



François Couperin



Antonio Vivaldi



Jean-Philippe Rameau



Alessandro Scarlatti

Johann Sebastian Bach



Johann Sebastian Bach (1685 – 1750) është kompozitor gjerman, organist, një nga muzikantët më të mëdhenj të të gjitha kohërave, i quajtur edhe "mjeshtër i mjeshtërve".

Lindi në Eisenach në një familje muzikore. Pas mbarimit të shkollimit, punoi si organist dhe violinist në disa qytete anembanë Gjermanisë, duke arritur përfundimisht pozicionin e drejtorit muzikor në Leipzig, ku mbeti deri në fund të jetës së tij. Kompleksiteti i veprave të tij u zbulua shumë më vonë, dhe megjithëse sot konsiderohet si një nga kompozitorët më të zgjuar, gjatë krijimtarisë së tij, ai arriti vetëm vlerësimë mesatare.

Zotërimi i përsosur i polifonisë dhe harmonisë, ndër të tjera, i mundësoi Bach-ut të bëhej një shembull dhe mësues për të gjithë ndjekësit e tij. Numri i madh i veprave të tij, shumë prej të cilave

kompozime kishtare, dhe pothuajse të gjitha, qoftë për qëllime edukative ose të kompozuara me porosi, përmblidhen deri diku në: 220 kantata të ruajtura, oratorium, 4 pasia, 6 koncerthe branderburg, 2 koncerthe për violina, 1 koncert për dy violina, 7 koncerthe për piano, sonata barok, preludiume, fuga, tokata, invencione dypjesëshe dhe trepjesëshe etj. Shumica e tyre janë shkruar për organo, çembalo, violinë dhe piano.



George Frideric Handel



Georg Friedrich Handel (1685 – 1759) është një kompozitor gjermano-anglez, organist, çembalist dhe përfaqësues tipik i barokut. Ndryshe nga stili kompleks i bashkohanicut të tij Bach, Handel e paraqet këtë drejtim muzikor në një mënyrë më të thjeshtë dhe më komunikuese.

Sigurisht që ky stil është edhe pasqyrë e jetës së tij. Ndërsa Bach nuk u largua kurrë nga Gjermania, Handel, i cili udhëtoi nëpër Evropë dhe mësoi shumë tradita të ndryshme muzikore, konsiderohet si një kompozitor ndërkombetar. Ai lindi në Halle në një familje jo muzikore, por me gjithë kundërshtimin e babait të tij për tu marrë me muzikë, ai arriti të arrijë qëllimin e tij me mbështetjen e madhe të nënës së tij. Ai u bë anëtar i Orkestrës së Hamburgut dhe më vonë, në Itali, përsosi teknikën e tij të kompozimit. Pozicioni i tij i fundit ishte drejtor i Operës së Londrës, ku qëndron deri në fund të jetës.

Vepra e tij përfshin më shumë se 40 opera, rreth 30 oratoriume, nga të cilët spikat "Mesia", kantata, sonata barok, koncerete për organo dhe orkestër, 12 koncerete grosi, 6 opera, koncerete për flaut, oboe, fagot, violinë dhe piano. Veçanërisht bie në sy fakti se Handel konsiderohet si krijuesi i oratoriumit klasik.



Thonë se oratoriumi "Mesia" i Handel ishte aq i njojur, saqë zotërinjve u këshillohej të ndiqnin shfaqjet e tij pa shpata, dhe zonjat pa krinoline, në mënyrë që të ketë vend për më shumë audiencë.

• **Fuga** (*fugare* – gjueti, ndjekje, vrapim) – një krijim polifonik në të cilin një ose më shumë tema zbatohen në të gjithë zërat në parimin e imitimit dhe sipas një plani të caktuar modelues. Fuga është forma më domethënëse dhe më e përsosur e stilit barok polifonik instrumental dhe vokalo-instrumental. Zakonisht shkruhet për 3 ose 4 zëra, më rrallë për 2, 5 ose më shumë. Tema e fugës fillimisht paraqitet e vetme, në tonalitetin bazë dhe më pas zëri i dytë e merr për një interval kuartet më lart ose për një kuartet më të ulët dhe në zërin e tretë rishfaqet në tonalitetin bazë etj. Kompozitori J. S. Bach konsiderohet si krijuesi i patejkalueshëm i fugës.

Toccata and Fugue in D Minor

J.S. Bach
Arranged by Stuart Carlson
Edited by Stephen Shipps

Adagio $\text{♩} = 69$

Toccata

Violin ff

Prestissimo $\text{♩} = 160$

Oratoriumi – një vepër vokalo-instrumentale për solistë, kor, orkestër dhe nganjëherë recitures. Në fillim ka qenë me tekst fetar shpirtëror, dhe më pas shfaqet edhe me tekst laik. Është e ngjashme me operën, ka një efekt dramatik dhe shfaqet në një skenë koncerti. Në barok, figura më e shquar në muzikën oratorike ishte Handel.




- **Çembalo/klaviçembalo** - një instrument muzikor me tastierë, paraardhësi i pianos. Më shpesh është përdorur në periudhën barok. Tingulli prodhohet duke shtypur tastet, të cilat tërheqin telat brenda vetë instrumentit, duke prodhuar një tingull të ngjashëm me atë të kitarës.



- **Violina** – një instrument harkor me katër tela, që prodhon tonet më të larta, në krahasim me të gjitha instrumentet e tjera me tela.

Përbëhet nga një korpus (trupi, kutia rezonante), qafa dhe koka me katër çelësa, mbi të cilat shtrëngohen telat. Violina luhet me një objekt të bërë nga një shufër druri me qime kali të shtrirë e të përpunuar. Tingulli prodhohet duke kaluar vargun nëpër tela.



Test i njohurive:

1. Jepni të dhënat për paraqitjen e barokut muzikor!
2. Përshkruani pamjen e muzikës barok duke e krahasuar me artet e tjera të asaj periudhe!
3. Jepni një pasqyrë të shkurtër të jetës dhe veprës së J. S. Bach dhe G. F. Handel!

Dëgjimi i muzikës:

Fragmente të:


- J. S. Bach Tokata dhe fuga në d - moll për organo
G. F. Handel, oratoriumi "Mesia" ("Halleluja")

KLASICIZMI


Përfaqësues të klasicizmit



Jacques-Louis David
(piktor)



Friedrich Schiller
(poet, daramaturg)



Jean-Jacques Rousseau
(filozof, shkrimtar, kompozitor)



Jonathan Swift
(satirist, shkrimtar)

Klasicizmi (classicus - i klasit të parë, shembullor, i përjetshëm) është emri i drejtimit artistik, e si rrjedhim edhe muzikor, i cili zgjati nga viti 1730 deri në 1820 dhe i cili tentoi në mënyrë tematike të përbledhë më të mirën dhe më të përjetshmen nga të gjithë paraardhësit e tij muzikorë. Kundrejt barokut të vonshëm (rokoko/paraklasika – 1720-1770), i njohur për ekstravagancën e tij, klasicizmi më tepër anon nga qartësia, ekuilibri dhe thjeshtësia. Punimet duhet të janë proporcionale dhe harmonike, shprehje e bukurisë klasike.

Pikëpamjet e tilla u ndikuan edhe nga klima e atëhershme politike, filozofike dhe artistike, siç është themelimi i Deklaratës për të Drejtat e Njeriut në SHBA në 1776 dhe Revolucioni Francez në 1789. Mbizotëron racionalizmi, ideja e kozmopolitizmit dhe ringjallja e lashtë e bukurisë ideale si një shembull i thjeshtë por i patejkalueshëm për të gjithë krijuesit në të tashmen.



Jacques-Louis David – *Përbetimi i Horoacio*, 1784

Do të mësojmë për:

- klasicizmin dhe muzikën në klasicizëm;
- përfaqësues të klasicizmit muzikor;
- shfaqjen e simfonisë dhe kuartetit të harqeve.

Terme të reja:
SIMFONIA | KUARTETI I HARQEVE | ARIA

MUZIKA NË KLASICIZËM

Klasicizmi i hershëm, përfaqësues muzikorë



Luigi Boccherini



Johann Stamitz



Carl Philipp Emanuel Bach

Strukturimi i rreptë i veprës artistike garanton qëndrueshmërinë dhe cilësinë e saj, si dhe universalitetin e saj. Ky rregull estetik mundësoi të del në sipërfaqe gjenialiteti i tre kompozitorëve më të famshëm klasikë - klasikët Vienez, të cilët krijuan në periudhën e klasikës së vonshme (1770–1830), Franz Joseph Haydn, Wolfgang Amadeus Mozart dhe Ludwig van Beethoven.

Në vend të polifonisë, gjithnjë e më shpesh vjen në shprehje muzika homofonike (homofonia), largohet motorika në kurrit të simetrisë dhe periodicitetit. Simfonia klasike orkestrale, koncerti, violina, sonata e pianos dhe kuarteti i harqeve bëhen format kryesore në të cilat forma klasike katërpjesëshe bëhet rregull: Allegro-Adagio-Menuetto-Finale (Allegro) me përashtime të vogla, si për shembull futja e Scherzo e Beethoven-it në vend të Menuetto. Instrumentet më të përdorura janë: violina, çembalo, piano, klarineti, oboë dhe flauta.



Kalaja në Mannheim

Franz Joseph Haydn



Franz Joseph Haydn (1732–1809) është një kompozitor austriak dhe themeluesi i simfonisë klasike dhe kuartetit të harqeve. Që i vogël, ai spikati me zérin e tij të bukur, dhe deri në moshën 18-vjeçare këndoi në një kor të famshëm fëmijëror Vienez. Ai zotëroi format e muzikës, luajti disa instrumente muzikore dhe punoi në pozicione të ndryshme në disa qytete, përpara se të arrinte famë dhe të punësohej në oborrin e kontit Esterházy në Eisenstadt, duke qëndruar në atë pozicion për 30 vjet.

Veprat e tij përfshijnë motive popullore, melosin gjerman, francez dhe hungarez, kurse opusi e tij përfshin rreth 120 simfoni, 24 opera, mbi 100 sonata për piano, më shumë se 70 kuartete harqesh, 35 trio për piano, violinë dhe violonçel, 30 tria për harqe, 9 piano, 9 koncerте për piano, 9 për violinë dhe 6 për violonçel. Ai është gjithashtu autor i veprave me tematikë fetare - 14 mesha dhe 2 oratoriume.

Wolfgang Amadeus Mozart




Wolfgang Amadeus Mozart (1756–1791) është një kompozitor austriak dhe një nga muzicientët më të famshëm të të gjitha kohërave. Reputacioni i gjeniut e ndoqi qysh në moshë të vogël: lindi në një familje muzikore, filloi të luante dhe të kompozonte qysh në moshën 4-vjeçare, gjë që i dha të parin nga shumë epitetet, “mrekullia e një fëmije” (wunderkind). Me motrën e tij të talentuar, nën kujdesin e të atit, organizoi koncerthe në disa qendra evropiane dhe më pas fitoi para në mënyra të ndryshme: duke luajtur nëpër oborre para njerëzve të shquar, duke dhënë koncerthe dhe duke kompozuar sipas porosisë. Ai ishte ekscentrik dhe kishte një jetë të turbullt dhe pasi u martua dhe u transferua në Vjenë, vdiq në moshën 35 vjeçare, me shëndet të dobët dhe probleme financiare.

Ai kishte një vesh absolut, memorie të jashtëzakonshme dhe aftësi për të kompozuar me shpejtësi. Puna e tij është e gjerë dhe ka krijuar në të gjitha zhanret muzikore, duke krijuar

rreth 600 vepra, nga të cilat dallohen: 41-53 simfoni, 22 opera, 105 minuetë, 56 valle gjermane, 40 këngë, kuartete harqesh, trio piano, sonata, kuintete harqesh, mbi 50 koncerete për instrumente të ndryshme, oratoriume, mesha dhe një rekuiem i papërfunduar.

„Muzika nuk është në nota, por në heshtjen mes tyre.“
Wolfgang Amadeus Mozart

Ludwig van Beethoven



Ludwig van Beethoven (1770–1827) ishte një kompozitor gjerman, një nga kompozitorët më universalë, më të shquar të të gjitha kohërave. Që në moshë të vogël u detyrua të bëhej i pavarur dhe të fillonte të siguronte jetesën duke kompozuar dhe luajtur shumë instrumente. Ai u takua me Mozart-in dhe Haydn-in në Vjenë, dhe më pas edhe u transferua atje. Qysh në rininë e hershme e tij humbi dëgjimin, gjë që ia vështirësoi dukshëm profesionin e kompozitorit, por ai sërisht nuk hoqi dorë.

Ai jetoi një jetë të tërhequr kurse fryshtimin kryesor për punën e tij e gjeti në idealet demokratike të Revolucionit Francez dhe respektin që kishin bashkëqytetarët e tij për të. Interesant është fakti se vdekja e tij në 1827 duket se ka paralajmëruar fundin e klasicizmit në 1830, pavarësisht se vetë Beethoven-i konsiderohet një kompozitor tek i cili paraqiten tendenca romantike.

Kjo tashmë mund të vërehet në shkeljen e tij të vazhdueshme të rregullave klasike, muzikore. Pra, ai i sundoai aq mirë saqë i lejoi vetes të bënte ndryshime individuale harmonike dhe formale. Veprat e tij më të famshme zakonisht i përkasin një prej tre fushave në të cilat ai u dallua veçanërisht – simfonitë (gjithsej 9), 16 kuartetet për harqe dhe 32 sonata për piano. Ai shkroi gjithashtu 1 operë, 10 sonata për violinë, 5 sonata për

violonçel, 9 tria për piano, 5 koncerete për piano, 1 koncert për violinë, 11 uvertura, 2 mesha, variacione për piano, oratoriume, kantata, vepra muzikore-kamertale, dans, këngë, etj.

Für Elise

WoO 59

Ludwig van Beethoven
(1770–1827)

Piano

Poco moto

The musical score for 'Für Elise' (WoO 59) by Ludwig van Beethoven. It is a single-piano piece in common time (indicated by '3'). The key signature is A major (one sharp). The dynamic is 'pp' (pianissimo). The title 'Für Elise' is written above the staff, and 'WoO 59' is below it. The composer's name and birth/death years are printed to the right of the title. The musical notation consists of two staves: the upper staff for the treble clef and the lower staff for the bass clef. The music features a series of eighth-note patterns and rests, typical of the piece's melodic line.

• **Simfonia** – kompozim instrumental, zakonisht në katër pjesë me ritëm të shpejtë - të ngadalshëm - mesatarisht të shpejtë, i përsosur në kohën e klasicizmit. Ajo kryhet nga një ansambël i madh muzikor, e ashtuquajtura orkestra simfonike, e cila përfshin pothuajse të gjitha llojet e instrumenteve, ku të gjithë janë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë, pa dominuar asnjëri mbi të tjerët. Në raste të jashtëzakonshme, kompozitori mund të prezantojë një kor, siç është Beethoven-i në pjesën e fundit të simfonisë së tij të 9-të - "Oda e Gëzimit".



• **Kuarteti për harqe** – një ansambël i vogël me katër muzikantë që luajnë instrumente me harqe - dy violina, violë dhe violonçel (dhe kompozimi që ata performojnë mban të njëtin emër - kuartet për harqe).



Vëllai i pasur dhe arrogant i Beethoven-it i dërgoi kompozitorit një urim për Vitin e Ri. Në fund firmosi: “*Johan van Beethoven, pronar i pasurisë*”.
Kompozitoria ia ktheu kartolinën duke shkruar në anën e pasme –
“*Ludwig van Beethoven, pronar i trurit*”.

Shembull muzikor:

Kuarteti për harqe nr. 62 në C-dur, paragrafi i dytë, nga F. J. Haydn (melodia e njojur sot si himni kombëtar i Gjermanisë)

Aria nga opera "Flauti Magjik" nga W. A. Mozart

Premiera e operës gjermane singspiel "Flauti Magjik" u mbajt në Vjenë në vitin 1791, në dy akte, me një kombinim të pjesëve të folurit dhe pikave muzikore, arieve dhe të ngjashme. Veprimi dramatik bazohet në një fabule fantastike, e cila zhvillohet në një vend të largët të përrallave. Flet për luftën midis së mirës dhe drejtësisë, të përfaqësuar nga prifti Sarastro, dhe të keqes së botës së krimit, të sunduar nga Mbretëresha e Natës. Flauti magjik është një objekt që ka fuqi magjike, dhe me këtë një arsy që të gjithë të luftojnë për të, duke simbolizuar, në këtë mënyrë, muzikën që na ndjek gjatë gjithë jetës. Aria e kënduar nga Mbretëresha e Natës është një nga seksionet solo më të vështira për shkak të lartësisë së toneve dhe teknikës së performancës, e cila mund të interpretohet vetëm nga soprano.



Simfonia nr 5, op. 67, në c - moll "Simfonia e fatit", paragrafi I, L. V. Beethoven

Premiera e simfonisë u mbajt në Vjenë në vitin 1808, me një kohëzgjatje totale prej rreth 30 minutash. Fillimi është i errët, por vendimtar, plot luftë dhe shpirt, ndërsa drita e shpresës kalon nëpër një stuhi. Nisur nga motivi fillestar, që lidhet me mënyrën se si “fati troket në derë”, zhvillohet i gjithë paragrafi i parë. Ky motiv bashkon të gjithë veprën. Tema është plot ankth dhe shqetësim, e ndjekur nga një melodi e re (tema e dytë), e butë, e ndritshme, e luajtur me violinë, kurse nga ana tjetër gjatë reprizës, prezantohet një pjesë mbresëlënëse e luajtur në oboë.

Symphony No 5, in C minor

Beethoven

A musical score for piano, featuring two staves. The top staff is in treble clef and the bottom is in bass clef. Both staves are in 2/4 time with a key signature of four flats. Measure 1 starts with a dynamic of *ff*. Measures 2 and 3 show eighth-note patterns. Measure 4 begins with a sustained note. Measure 5 starts with a dynamic of *p*. Measures 6 through 8 feature sustained notes and chords.

Test i njohurive:

1. Rendisni veprat më të famshme të F. J. Haydn!
 2. Bëni një kahasim midis rrugës së jetës dhe vepra e W. A. Mozart dhe L. V. Beethoven!

Dëgjimi i muzikës (fragmente):

Franz Joseph Haydn: Fragment i një kuarteti për harqe

Wolfgang Amadeus Mozart: aria nga opera
Flauti Magijk

Ludwig van Beethoven: Simfonia nr. 5, op. 67, në c-moll, paragrafi I

ROMANTIZMI

Romantizmi është emri i drejtimit artistik që u shfaq në shekullin XIX si një reagim ndaj klasicizmit. I frymëzuar nga Revolucioni Francez dhe ngjarjeve të tjera të ngjashme politike në të gjithë Evropën dhe botën në atë kohë, romantizmi i hedh poshtë fuqishëm idealet racionaliste dhe kozmopolite të paraardhësit të tij. Në te formulohen idetë e para të përkatësisë kombëtare dhe vëmendja fokusohet në konfliktin midis një shoqërie shtypëse dhe individit. Individualizmi del në plan të parë.


Përfaqësues të romantizmit



Francisco Goya
(piktor)



Johann Wolfgang von Goethe
(poet)



George Gordon Byron
(poet)



Mary Shelley
(poete)



Alexander Sergeyevich
Pushkin
(poet)



George Sand
(shkrimtare)

Do të mësojmë për:

- romantizmin dhe romantizmin muzikor;
- përfaqësues të romantizmit muzikor;
- ansamblet interpretues nga epoka e romantizmit;
- paraqitjen e këngëve-solo dhe e poemës simfonike.

Terme të reja:

KËNGË-SOLO | POEMA SIMFONIKE | KONCERT | BALET


Përfaqësuesit muzikorë të romantizmit



Felix Mendelssohn



Robert Schumann



Pyotr Ilyich Tchaikovsky

Edvard Grieg, Franz Liszt, Frédéric Chopin, Johannes Brahms, Hector Berlioz, Clara Schumann, Mikhail Ivanovich Glinka, Alexander Borodin, Modest Petrovich Mussorgsky, Nikolai Rimsky-Korsakov, Bedřich Smetana, Antonín Dvořák, etj.

*"Është muzika ajo që na
tregon se raca njerëzore është
më e madhe nga sa
mendojmë."*

Napoleon Bonaparte

Romantikët ikin nga realiteti në botën e fantazisë, kanë mall për të kaluarën dhe disa destinacione të reja ekzotike, i kthehen krijimtarisë popullore dhe folklorit vendas si burim fryshtimi dhe gjijnë strehim në natyrë. Pesimizmi i tyre reflektohet në veprat që krijojnë dhe kufijtë e rreptë mes arteve të ndryshme fillojnë të zbehen.

Artisti-gjeni i vetmuar, ndryshtë nga artisti klasik, ka të drejtë, por edhe detyrë ndaj vetes, t'i mohojë të gjitha rregullat e paracaktuara paraprakisht dhe, mbi të gjitha, në veprat e tij të shprehë gjendjen e tij aktuale shpirtërore.

Zgjimi i ndërgjegjes kombëtare u jep mundësi edhe artistëve që nuk kanë origjinë nga shtetet e atëhershme dominante si Italia, Gjermania, Franca dhe Austria, si për shembull muzikantët me origjinë sllave, të shprehen dhe të kontribuojnë në mbarë skenën muzikore evropiane.

Në muzikë, kjo sjell risi dhe shkakton pasurim shtesë të lëvizjes melodike, zgjerimin e harmonisë, kromatikën dhe diversitetin, nga njëra anë rritjen e orkestrës, por edhe popullarizimin e formave të reja, të shkurtra, si kënga solo, miniaturë për piano dhe poema simfonike, përmes së cilëve mund të shprehin në mënyrë më efektive ndjenjat aktuale të artistit.

Franz Peter Schubert



Franz Peter Schubert (1797–1828) ishte një kompozitor, violinist, pianist, organist dhe këngëtar austriak. Ai është një figurë kyçë në romantizmin muzikor. Ai lindi në një familje të madhe dhe për arsyet e ndryshme nuk mundi të fitonte mjaftueshëm para nga kompozimi i muzikës, gjë që e bëri atë të transferohej në Vjenë dhe të bënte një jetë artistike, boheme, i rrëthuar nga njerëz të tij njëjtë mendim. Identifikimi i tij biografik me disa nga pikëpamjet kryesore romantike çoi në vdekjen e tij të parakohshme, por edhe në krijimin e një opusi të madh dhe domethënës.

Është mjeshtër i këngës solo, muzikës simfonike dhe kamertale. Krijimtaria e tij përfshin rrith 1500 vepra, nga të cilat 600 këngë solo, 9 simfoni (sipas shembullit të idhullit të tij Beethoven, përballë të cilit edhe është varrosur), 18 vepra muzikore dhe skenike, 15 kuartete për harqe, sonata për piano, tance, mesha etj.

- **Këngë solo** – kompozim i destinuar për një zë/vokal, me tekste të poetëve të njojur të kohës së romantizmit, zakonisht me shoqërim instrumental (piano), e më vonë edhe orkestral. Autorë të njojur të këngëve solo janë: Schubert, Schumann, Brahms, List, Glinka, Tchaikovsky, Rachmaninoff, Borodin, Mahler etj.

- **Miniatura për piano** – një kompozim i shkurtër instrumental, më i thjeshtëzuar në formë dhe performancë se kënga solo. Pa fjalë, por i përshtatshëm për të shprehur gjendjen aktuale të romantikut. Autorë të njojur të miniaturave për piano janë: Schumann, List, Chopin dhe Mendelssohn.

- **Koncert** – vepër muzikore, zakonisht trepjesëshe, për instrument solo me shoqërim orkestral. Ka koncerthe për piano, violinë, violonçel, flaut, obo etj.

THE ERL KING
DER ERLKÖNIG

GOETHE

FRANZ SCHUBERT
Op. 1.

1 Presto (♩ = 152)

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

Who
Wer

High
(Orig.)

Një nga kompozimet më të famshme të Schubert-it, "Mbreti i Malit", një këngë e errët dhe dramatike e bazuar në poemën me të njëjtin emër të Goethe, është shkruar kur kompozitori ishte adolescent. Tregon historinë e një babai dhe birit të tij që kalojnë nëpër një pyll në një natë dimri, ndërsa djalit i parafytyrohet Mbreti Malor, i cili dëshiron ta joshë atë në mbretërinë e tij. Këngëtari duhet të këndoje rolet e babait dhe të birit dhe shpirtit të keq dhe rrëfimtarit, i cili përshkruan udhëtimet e tyre.

Dëgjimi i muzikës:
Franz Schubert - „Ave Maria“

Bedřich Smetana



Bedřich Smetana (1824–1884) është kompozitor, pianist, dirigjent çek, themelues i shkollës kombëtare çekë, kritik dhe themelues i disa shoqërive muzikore. Ai nuk vjen nga një familje muzikore, por dashuria për muzikën popullore që ia kishte rrënjosur që në moshë të vogël nga i ati, e nxiti të krijonte vepra origjinale, ku përfshiheshin lutje çekë popullore.

Ai jetoi në Suedi për një kohë, kurse pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi në Pragë, ku edhe themeloi një shkollë muzikore. Ai u vendos jo vetëm si kompozitor i rëndësishëm kombëtar, por edhe si kritik dhe mësues, i cili e përhapi veprimtarinë muzikore tek gjeneratat e reja. Dhjetë vjet para se të vdiste, në Pragë, ai humbi dëgjimin dhe më vonë pësoi edhe kriza mendore. Ai kompozoi 8 opera, nga të cilat më e rëndësishmja është e para, "Nusja e shitur", këngë solo dhe korale, 9 lojëra çekë me piano dhe ciklin më të famshëm me 6 poema simfonike "Ma Vlast", që iu kushtua bukurive të atdheut të tij. Nga ky cikël poezish spikat "V'ltava".

Poema simfonike - vepër programore-orkestrale në një paragraf, zakonisht në formë sonate, rondo ose variacione. Kompozitorë të njohur të poezive simfonike janë: Franz List, Bedřich Smetana, Richard Strauss, Cesar Frank, Ian Sibelius.



Lumi V'ltava në Pragë

Dëgjimi i muzikës:

Bedřich Smetana, poema simfonike "V'ltava"

Pyotr Ilyich Tchaikovsky



Pyotr Ilyich Tchaikovsky (1840–1893) është një kompozitor rus dhe në të njëjtën kohë romantiku më i njohur në vendin e tij. Për muzikën shfaqi interes që në fëmijëri dhe në riminë e hershme u regjistrua në Konservatorin e Petrogradit dhe menjëherë më pas u punësua si profesor në Konservatorin e Moskës. Pas një kohe të caktuar ai la punën e tij për të udhëtar nëpër Evropë dhe botë, ku krijoi shumë nga kompozimet e tij më të famshme.

Me origjinë nga një vend i vogël, rural, Tchaikovsky përfshiu shumë motive folklorike ruse në artin e tij, të cilat më vonë i kombinoi me mjeshtëri me traditën perëndimore, klasike, kompozicionale. Ai është veçanërisht mbresëlënës si tekstshkrues dhe dramaturg i shquar, dhe ka shkruar pothuajse të gjitha llojet e kompozimeve, sipas disa statistikave mbi 80 sosh. Veprat e tij më të njohura janë baletet "Liqeni i Mjellmave", "Arrëthyesja" dhe "Bukuroshja e Fjetur", operat "Pikova Dama" dhe "Eugene Onegin", si dhe

koncerete për piano dhe violinë, 6 simfoni, uvertura dhe kuratë për harqe.

• **Baleti** – vallëzim artistik, skenik, i realizuar nga një ose më shumë persona, balerina dhe baletan, me shoqërim muzikor. Në fillim (nga shekulli i XVII-të deri në shekullin e XVIII-të) ishte pjesë e operave, kurse në shekullin e XIX-të u bë i pavarur dhe arriti një ngritje të konsiderueshme. Autorë të mëdhenj të baletit janë: Petar Ilyich Tchaikovsky, Charles Gounod dhe të tjerë.



Skena nga baleti "Arrëthyesja"

Test i njohurive:

1. Çfarë është një këngë solo?
2. Cila nga veprat më të njohura muzikore të Petar Ilyich Tchaikovsky bazohen në veprat letrare dhe përrallat?

OPERA NË ROMANTIZËM

Opera (opus - vepër; do të thotë "dramë e kënduar") është një vepër muzikore-skenike në të cilën veprimi dramatik transmetohet duke kënduar tekstin e shoqëruar nga një orkestër. Interpretuesit kryesorë janë solistët vokalë, me interpretimin e arieve, dueteve etj., më pas kori, i cili zakonisht është në përbërje të përzier dhe realizon skena masive, orkestra dhe dirigjenti që menaxhon dhe harmonizon të gjithë komponentët.

Opera, e cila zyrtarisht u shfaq në fund të Renesansës, pra në fillim të barokut, dhe më vonë iu nënshtrua reformave të rëndësishme nga kompozitori Christoph Willibald Gluck në periudhën e klasicizmit, arriți kulmin e saj të vërtetë vetëm në periudhën e romantizmit. Deri atëherë, jo vetëm që shumica e "të metave" të saj u çrrënjosën dhe korrigjuan, por u bë formati muzikor më i suksesshëm dhe më tërheqës për audiencën mesatare.

Kjo pjesërisht i dedikohet temës aktuale, e cila është zakonisht lirike, dashurie, luftarake, historike, por edhe karakteristike romantike, fantastike dhe folklorike. Gjithashtu, opera është në thelb një sintezë komplekse e disa arteve – muzikës, dramës dhe poeziës (në libretot), baletit, koreografisë, kostumgrafisë dhe skenografisë, dhe për këtë arsy, ajo është mishërim i një prej idealeve artistike të asaj kohe.

Ekzistojnë dy lloje të operave sipas natyrës së përbajtjes – opera seria (operë serioze) dhe opera buffo/komike (operë komike), e cila u krijua në periudhën e klasicizmit, por kurrë nuk arriti të arrijë popullaritetin e origjinalit, variantit tragjik.

Aria është një pjesë e pavarur e operës, e interpretuar nga një solist vokal me shoqërim instrumental. Edhe pse është një fragment nga një ansambël më i madh, shpesh interpretohet edhe në format koncerti.



Skenë nga opera "Turandot" - Giacomo Puccini

Në shekullin e XIX-të, popullariteti i saj arriti përmasa të tilla, saqë u shfaqën grupe kompozitorësh që kompozuan vetëm opera. Ky theks mbi veprat muzikore me një efekt të theksuar dramatik çon në refuzimin e pjesshëm të disa aspekteve të estetikës romantike, gjë që shkakton shfaqjen e verizmit (të vërtetës), një drejtim në operën italiane paralel me realizmin letrar/natyralizmin. Për ndryshim nga sfondi mitologjik dhe fantastik i operave të deritanishme, verizmi flet për ngjarjet e përditshme të jetës së njerëzve dhe heronjtë e tij i paraqet si personazhe me të meta, nxite të forta dhe pasione, të cilat pothuajse gjithmonë çojnë në xhelozë dhe vdekje. Përmes operave veriste, pasqyrohen emocionet dhe psikologjia e njerëzve. Ato përfshijnë shumë melodi, të ngjashme me këngët populllore, të cilat synojnë të tregojnë jetën reale ashtu siç është.

Kompozitorët më të shquar të operës në romantizëm




Carl Maria von Weber



Gaetano Donizetti



Vincenzo Bellini




Charles Gounod



Skenë nga opera “Cavalleria rusticana” – Pietro Mascagni



Camille Saint-Saëns



Jules Massenet



Ruggero Leoncavallo



Pietro Mascagni


Giuseppe Verdi




Giuseppe Verdi (1813–1901) është një kompozitor italian që u përfshi në muzikë në një moshë relativisht të "vonshme", falë këmbënguljes dhe punës së tij me profesorë privatë, ai arriti sukses universal. Ai njihet, mbi të gjitha, për operat e tij dhe konsiderohet si një nga autorët muzikorë më pjellorë të shekullit XIX.

Pikëpamjet e tij demokratike dhe revolucionare pasqyrohen edhe në opusin e tij, i cili karakterizohet nga teatraliteti dhe masiviteti karakteristik dhe e portretizon Verdin si një mjeshtër të teknikës korale.


Për nga përbajtja, ai është një përfaqësues tipik i verizmit, i fokusuar te mizoria e jetës dhe shpeshherë tregon histori dashurie të shfrenuara që kanë gjithmonë një përfundim tragjik. Ndër operat e tij të interpretuara shpesh janë: Nabucco, La Traviata, Troubadour, Rigoletto e të tjera.



“Aida” është një operë me katër akte, e porositur dhe e shfaqur për herë të parë në Kairo në vitin 1871, me rastin e hapjes së Kanalit të Suezit. Konsiderohet si një kryevepër e Verdit. Ngjarja ndodhet në Egjiptin e lashtë, kur sundonte faraoni. Kjo vepër flet për dashurinë e ndaluar mes udhëheqësit ushtarak Radames dhe skllaves Aida, e cila përfundon me vdekjen e tyre.



Skena nga opera „Aida“



"Marshi Triumfal", segmenti më i famshëm muzikor i kësaj opere, është një pjesë instrumentale nga mesi i veprës, e cila feston fitoren ushtarake të Radames për nder të Egjiptit dhe perëndeshës Isis. Shfaqja përfshin edhe pika baleti.

Gioachino Rossini



Gioachino Antonio Rossini (1792–1868) është një kompozitor italian, mbi të gjitha, i operës. Veprën e parë skenike e krijoj në moshën 18-vjeçare. Punoi si kompozitor i përhershëm në Teatrin e Operës së Napolit, për një kohë të shkurtër dhe si drejtor i Teatrit Italian në Paris, dhe më pas u bë kompozitor mbretëror dhe mori titullin Kryeinspektor i Këndimit. Veprimtaria e tij përmban rreth 36 opera, vepra kishtare, kantata, romanca. Kryevepra e tij është opera realiste bufo (komike) "Berberi i Seviljës".

“Berberi i Seviljës” është vepër në dy akte. Rossini e shkroi atë kur ishte 24 vjeç dhe, besohet, në më pak se tre javë. Aksioni zhvillohet në Sevilja të Spanjës dhe mbulon historinë e dashurisë mes të resë Rosina dhe kontit Almaviva, i cili ndihmohet nga

berberi Figaro. Është një adaptim i pjesës së parë të trilogjisë nga dramaturgu francez Pierre Beaumarchais (pjesa e dytë u adaptua në operën Dasma e Figaros nga Mozart-i), dhe u shfaq premierë në Romë në 1816.



Uvertura e "Berberit të Seviljës" është një nga pjesët më të famshme muzikore deri më sot, por për ironi të fatit, nuk është shkruar fare për këtë operë. Është përdorur në dy opera të mëparshme nga Rossini, kështu që mendohet se ka një shkëputje të dukshme muzikore midis saj dhe pjesës tjetër të veprës.

• **Uvertura** – një hyrje instrumentale në format skenike opera, opereta dhe balet, që paralajmëron përbajtjen dhe karakterin e veprës. Shpesh interpretohet edhe në koncerте, jashtë skenës së operës.

Në një ngjarje ku mori pjesë kompozitori Rossini, një këngëtar i ri iu kërkua të këndonte një nga ariet e tij të operës.

- Ah, maestro! -tha ajo e emocionuar. - Sa e frikësuar jam!
- Sikur ta dije sa i frikësuar unë jam! - u përgjigj Rossini.

Dëgjimi i muzikës:

Giuseppe Verdi: "Marshi Triumfal" – fragment nga opera Aida
Gioachino Rossini: Uvertura nga opera „Berberi i Seviljës“

Richard Wagner

Richard Wagner (1813 - 1883) është një kompozitor, mendimtar dhe reformator gjerman. Ai lindi në Leipzig në një familje ku konsumohej arti teatror, që rezultoi të jetë vendimtare për përcaktimet e tij të ardhshme. Në fakt, është ndërthurja e muzikës dhe dramës që e shtyn atë të përpinqet të sintetizojë shumë arte të ndryshme në opera. Veprimi i tensionuar, i cili, sipas Wagner-it, duhet të lidhet ngushtë me vetë natyrën e muzikës, refuzon ariet, të cilat ai i zëvendëson me skena, si dhe fut lajmotive (motive drejtuese të lidhura me personazhe/ngjarje të caktuara). Muzika duhet të jetë një interpretim emocional i dramës që zhvillohet në plan të parë, ndaj melodia duhet të ndjekë fjalimin e qartë dhe të krijojë një lidhje midis fjalës dhe tonit.

Veprat e Wagner-it janë kryesisht me përbajtje romantike, mitologjike dhe fantastike dhe tematikisht mbështeten në disa filozofi lindore dhe perëndimore, ndër të cilat më të spikaturat janë filozofia e Hegel-it dhe ajo e Schopenhauer-it.

Vepra e tij jetësore është tetralogjia e operës "Der Ring des Nibelungen", libretton e së cilës e shkroi vetë ai dhe që bazohet lirisht në më shumë legjenda të mitologjisë nordike. Katër operat e këtij cikli: "Das Rheingold", "Die Walküre", "Siegfried" dhe "Götterdämmerung" zgjasin gjithsej rreth 15 orë, por shpesh interpretohen të pavarura. Fillimi i aktit të tretë të operës së dytë "Die Walküre", është një pjesë instrumentale, e cila zgjat rreth 8 minuta dhe zhvillohet me një shkallëzim gradual për të kulmuar me skenën kur katër Valkyrat (luftëtare femra të mitologjisë nordike), në majë të një mali i transportojnë luftëtarët e rënë për në jetën e përtejme.




Georges Bizet

Georges Bizet (1838 - 1875) është një kompozitor francez i cili rrjedh nga një familje muzikore. Në vetëm nëntë vjeç, në provimin pranues në Konservatorin e Parisit, ai e fascinoi komisionin. Më pas, në moshën 19-vjeçare, ai mori një çmim prestigjioz, i cili i mundësoi të kalonte tre vjet shkollim plotësues në Romë.

Veprat e tij më të shquara përfshijnë 12 opera dhe lloje të tjera të muzikës skenike, suita orkestrale, muzikë simfonike, vepra për piano etj.



Skena nga opera „Carmen“




"Carmen" është një operë me 4 akte, e cila pavarësisht se në shfaqjet e saj fillestare nuk pati sukses për shkak të realizmit të madh, me kalimin e kohës ajo u rritur dhe ende konsiderohet si një nga operat më të mira dhe më të interpretuara të të gjitha kohërate. Aksioni zhvillohet në Sevilja dhe tregon historinë e vajzës provokuese Carmen, e cila josh rreshterin naiv Don Jose dhe, pas disa peripecive, vdes në duart e tij. Vepra është dramatike, me personazhe të ndërtuara, e pasur me melodi lozonjare, popullore, spanjolle dhe përmban disa nga ariet më të njobura në historinë e operës.

Dëgjimi i muzikës:

Richard Wagner - "Die Walküre", fragment nga opera "Die Walküre"
Georges Bizet - arie nga opera "Carmen"

IMPRESIONIZMI


Përfaqësuesit e impresionizmit



Claude Monet
(piktor)



Berthe Morisot
(piktore)



Pierre-Auguste Renoir
(piktor)



Claude Monet - "Impresioni, lindja e diellit", (1872)

Impresionizmi (impresion – përshtypje) është një lëvizje e shkurtër artistike që u shfaq në Francë në fund të shekullit të XIX-të, fillimisht në pikture dhe më pas në muzikë. Duke u mbështetur në të ndrrën romantike, impresionistët, si dhe homologët e tyre letrarë, simbolistët, izolohen më tej nga bota realiste, racionale dhe materialiste për të depërtuar në subjektivitetin e përshtypjeve. Si në pikurat ashtu edhe në kompozimet muzikore, shpesh gjenden përfaqësimë të natyrës, por jo në shfaqjen e vërtetë të saj, por si përvoja dhe si pjesë e atmosferës aktuale që frysmezoj artistin për të krijuar veprën. Domethënë, qëllimi i asaj vepre është pikërisht kapja e ndjenjës personale që ka shkaktuar përshtypjen. Në muzikë kjo arrihet me të ashtuquajturat “pikturimi tonik”, duke rritur koloritetin dhe duke futur harmoni më të lira. Shfaqet interes edhe më i madh për format e shkurtra, zakonisht piano, të cilat tingëlojnë të këndshme dhe ekzotike.

Claude Debussy

Claude Debussy (1862–1918) është një kompozitor, pianist, kritik dhe themelues francez dhe i vetmi përfaqësues i plotë i impresionizmit muzikor. Duke shfaqur interes dhe talent për muzikë që në fëmijërinë e hershme, ai u regjistrua në Konservatorin e Parisit në moshën 11-vjeçare, pas së cilës filloi karriera e tij e suksesshme dhe e larmishme. Ai mori çmimin prestigjioz “Çmimi i Romës” dhe udhëtoi botën, duke shjuar bukuritë e natyrës, peizazhet, perëndimet e diellit dhe tingujt ekzotikë specifikë të ritmeve të Lindjes së Largët dhe melodive popullore.

Ai i zbatoi këto përshtypje në kompozimet e tij, duke tejkaluar akordet standarde në dur dhe në mol duke përdorur triada me dy terce dhe duke braktisur plotësisht grupimet tradicionale të harmonive muzikore. Edhe pse kurrë ai nuk e pranoi termin impresionizëm për muzikën e tij, kur bëhet fjalë për këtë drejtim, përfaqësuesit e vetëm tipikë janë veprat e Debussy-t, më të njohurat prej të cilave janë:

kompozimet për piano (etude, arabeska, preludiume, nokturna), këngët solo, kantata dhe opera e tij "Pelléas et Mélisande", bazuar në veprën me të njëjtin emër të Maurice Metterlink.



CLAIR DE LUNE
from Suite Bergamasque

Edited by ROBERT SCHULTZ

CLAUDE DEBUSSY

Andante très expressif


“Shkëlqimi i Hënës” (*Clair de Lune*) nga Claude Debussy - paragrafi nga kompozicioni “Bergamo Suite” për piano, në taktin 9/8, në një ritëm të moderuar dhe ekspresiv, është frysmezuar nga poema me të njëjtin emër të poetit Paul Verlaine.

• **Arabesque** - një kompozim i shkurtër, i gjallë me tone dekorative, i frysmezuar nga meloditë arabe dhe i krijuar në periudhën rreth fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Dy arabeskat e famshme të Claude Debussy u kompozuan midis 1888 dhe 1901. E para përfaqëson zhurmën e ujit dhe ka një formë impresioniste, ndërsa e dyta është shkruar në stilin barok.

Kur Claude Debussy mbaroi “Prélude à l'après-midi d'un faune”, një vepër e frysmezuar nga poema e Mallarme me të njëjtin emër, ai ia çoi mësuesit të tij, Camille Saint-Saens, duke i kërkuar që ta shqyrtonte dhe të vendoste kryqe të vegjël në çdo vend që nuk i pëlqente. Kur shkoi të merrte kompozimin e tij, pa që nuk faqet e veprës nuk kishte kryqe, kështu që u gëzua shumë, por Saint-Saens nuk e la të gjëzohet gjatë:

- Po të kisha vënë kryq në të gjitha vendet ku i kërcëllova dhëmbët, faqet do të dukeshin si varreza!

Maurice Ravel



Maurice Ravel (1875–1937) është një kompozitor, kritik dhe pianist francez, përfaqësues i impresionizmit. Ai u rrit në Paris, ku studioi në Konservatorium. Ai u ndikua nga shumë kompozitorë, por kryesisht nga Debussy, për të zhvilluar më vonë stilin e tij, veçanërisht të ndryshëm nga ai i kolegut të tij impresionist. Ai konkurroi për “Çmimin e Romës” katër herë, por nuk ka marrë kurrë një çmim, pavarësisht suksesit të madh komercial dhe kritik. Ai ishte doktor nderi në Universitetin e Oksfordit.

Ai shquhej me përdorimin e tij karakteristik të melodisë dhe ritmit, në këtë mënyrë duke aluduar me vetëdije në vallet popullore, dhe stili i tij ishte i përbajtur dhe i saktë. Ai përdori një shkallë të plotë dhe, megjithëse arriti politonetin, si Debussy, ai kurrë nuk e kaloi kufirin atonal. Veprat e tij më të njoitura janë: kompozimi orkestral, unikja "Bolero", opera "Ora Spanjolle" dhe baleti "Daphne/Daphnis dhe Chloe".

"Bolero" nga Maurice Ravel është një kompozim orkestral, i projektuar si balet, kushtuar posaçërisht aktores dhe balerinës ruse Ida Rubinstein. Me të, Ravel dante të provonte se edhe një temë e përsëritur, e orkestruar në mënyrë perfekte, mund të tingëllonte interesante nëse përsëritjet do të ishin me ngjyra dhe dinamika të ndryshme instrumentesh. Vepra fillon e qetë, me turp, vetëm me një instrument goditjeje, ritmin e të cilit e dëgjojmë vazhdimit gjatë gjithë kompozimit 15-minutësh. Një nga një instrumentet frysore ndizen, pastaj harqet dhe të gjitha me një rritje graduale të volumit çojnë në një kulm. Kjo vepër është frysëzim për shumë koreografë dhe regjisore për ta përfshirë në veprat e tyre.



• **Bolero** – një term që ka shumë kuptime, por më së shumti i referohet kërcimit spanjoll të shekullit të 18-të, në takthin $\frac{3}{4}$, me një ritëm të ngadalta deri në mesatar. Performohet solo ose në çift, e shoqëruar me kastanjeta ose kitarë.

Dëgjimi i muzikës:
Claude Debussy – “Suite Bergamasque”
Maurice Ravel - "Bolero"

MUZIKA NË SHEKULLIN XX

Shekulli i XX është një nga periudhat më të trazuara planin shoqëror, dhe me këtë edhe në atë artistik. Globalizimi dhe përparimet e përshtypjura teknologjike (radio, gramafon, televizion) figurojnë paralelisht me ardhjen e armëve atomike dhe dy luftërat botërore. Paraqiten gjithnjë e më shumë drejtime në art, të cilat ndodhin në të njëjtën kohë dhe përpilen të vendosin një rend të ri, por në mënyra të ndryshme. Këto aspirata e bëjnë shumë interesante krijimin e muzikës në shekullin e XX. Kështu, në thelb, mund të flitet për ndarjen e: kompozitorëve tradicionalist dhe avangardë-modernistë (të avancuar).

Figura të rëndësishme të artit në shekullin e XX

Tristan Tzara (poet dadaist)

Guillaume Apollinaire (poet)

Frida Kahlo (piktore)

Franz Kafka (prozaist)

Vladimir Mayakovsky (poet)

Salvador Dalí (piktor)

Luis Buñuel (regjisori)


André Breton (shkrimtar)

Oskar Kokoschka (poet)

Filippo Tommaso Marinetti (poet)



Frida Kahlo
(piktore)



„Autoportret me gjerdan të grisur
dhe kolibri“ (1940)

Tradicionalistët vuajnë pas vlerave të humbura të së shkuarës, ndaj mendojnë se mund t'i rikthejnë ato nëse ndjekin shembullin e mjeshtërve klasikë. Drejtimet e tyre, të njoitura si neobarok, neoklasicizëm, neoromantizëm e të tjera, mbështeten në parafjalën "neo", që nënkupton një vështrim të ri në format muzikore tradicionale. Motoja e tyre është: "Kthim në shembujt e vjetër", duke iu referuar veprave të Bach, Haydn, Mozart, Beethoven etj. Ato mund ti hasim kryesisht në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore.

Nga ana tjetër, avangardistët (frëngjisht: *avant garde*, pararendës, roje përpëra), duan që me shekullin e ri të vijë një botë e re, më e mirë se e vjetra, të cilën do ta ndihmojnë në krijimin me ndihmën e veprave të rejave dhe eksperimentale të artit. Këta kompozitorë zakonisht i hasim pas Luftës së Dytë Botërore dhe karakterizohen nga fakti se ata refuzojnë plotësisht rregullat tradicionale.

Para dhe pas kësaj periudhe shfaqen stile, teknika dhe forma në të cilat kërkohen me guxim mjete të reja muzikore shprehëse, si: ritmi i theksuar, bashkëtingëlloret disonante, meloditë e lira e të kërcitur dhe qëndrimi novator ndaj burimeve folklorike.



Pikturë nga Wassily Kandinsky

Paraqitet e ashtuquajtur muzika atonale, dhe hiqen të gjitha kufizimet në trajtimin e melodisë, harmonisë, ritmit dhe formës. Ka një interes në rritje për muzikën instrumentale dhe veprat kompozohen për ansamble më të vogla kamertale, me dominimin në rritje të instrumenteve frymore dhe me goditje si solistike. Në avangardë haset një muzikë seriale, e cila është një ndërthurje tonesh me një ngjyrë, ritëm dhe dinamikë të caktuar; muzikë specifike, e cila përdor tinguj të modifikuar e të gatshëm jo muzikor për të bërrë kolazhe; aleatorikë, e cila bazohet në rastësi (si p.sh. hedhja e një kubi). Shfaqen vepra multimediale, kombinime të skenës operistike me filmin, radion dhe televisionin.



Igor Stravinsky



Sergei Prokofiev




Dmitry Shostakovich


Përfaqësues të muzikës bashkëkohore janë: Igor Stravinsky, Sergei Prokofiev, Dmitry Shostakovich, Aram Ilyich Khachaturian, Béla Bartók, Zoltán Kodály, Arnold Schoenberg, Paul Hindemith, Carl Orff, Benjamin Britten, Witold Lutosławski, Krzysztof Penderecki, e të tjerë. Shumica prej tyre kompozuan në shumë drejtime ose ndërthurën disa stile në veprat e tyre.



Béla Bartók



Zoltán Kodály



Aram Ilyich Khachaturian



Paul Hindemith



Krzysztof Penderecki

• **Ekspresionizëm** (shprehje) – e kundërta e impresionizmit. Paraqiten devijime nga të gjitha rregullat e mëparshme, me konstatimin e metodave të reja në kompozim.

• **Dodekafonia** – një sistem prej 12 tonesh (sistemi dymbëdhjetë-tonësh, seri dymbëdhjetë-tonshe) të cilin kompozitori e përdor në mënyra të ndryshme melodike dhe akordale në procesin e krijimit të veprës. Ky është një drejtëm në muzikën atonale që kritikohet, por edhe lë gjurmë të qëndrueshme. Përfaqësuesi më i famshëm është Arnold Schoenberg.

• **Muzika elektronike** – paraqitet me vetë zhvillimin e elektronikës dhe shkencës kompjuterike, të cilat i lejojnë kompozitorit të regjistrojë tinguj nga natyra dhe t'i kombinojë ato me instrumente. Përfaqësues i njohur i kësaj muzike është kompozitori francez Pierre Schaefer.

• **Minimalizëm** – përsëritje e motiveve të shkurtra melodike dhe ritmike me ndryshime të vogla. Ky stil u ndikua nga muzika afrikane dhe e Lindjes së Largët. Përfaqësuesi është Steve Reich.



Arnold Schoenberg

Përfaqësues të muzikës elektronike janë Pierre Boulez, Karlheinz Stockhausen, Robert Moog (shpikësi i sintetizatorit) dhe të tjera.




Karlheinz Stockhausen

Igor Stravinski

Igor Stravinsky (1882 - 1971) është një kompozitor, dirigjent dhe pianist rus. Ai jetoi në shumë vende të botës, për të kaluar vitet e fundit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku edhe vdiq. Ai u varros në Venecia të Italisë me kërkesë të tij. Vepra e tij i përket pothuajse të gjitha drejtimeve, stileve dhe teknikave të kompozimit, nisur nga jeta e tij e gjatë e punës. Poliritmiciteti në veprat e tij, pra shfaqja e njëkohshme e ritmeve të ndryshme në kompozime është diçka që i jep një shenjë të veçantë, si dhe fakti që të gjitha veprat i ka krijuar me ndihmën e pianos. Ai vetë deklaroi: "Çdo notë që shkruej e provoj në piano". Veprat e tij më të famshme janë baletet, melodramat, operat, simfonitë, suitat dhe veprat kamertale. Ai ka dekluaruar: "Publiku nuk duhet të jetë shumë i fokusuar te tonaliteti, atonaliteti, ritmi apo poliritmi, por duhet të vlerësojë

punën sipas mënyrës se si është në gjendje t'i bashkojë njerëzit dhe t'i lidh ata.



"Dedikim Pranverës", 1913, është një balet, i treti në serialet e Stravinskit pas "Zogut të Zjarrtë" dhe "Petrushka". Natyra avangarde e muzikës, koreografija ekzotike, skenografia dhe kostumgrafija e frysmezuar nga folklori sllav shkaktuan admirim dhe indinjatë. Vepra përshkruan një ritual të vjetër sllav, pagan, të festimit të pranverës që përfundon me vetëflijimin e një vajze të re. Konsiderohet si kompozimi më revolucionar që nga faza fillestare e Stravinskit, dhe karakterizohet nga zgjerimi i politonetit, metro-ritmit kompleks dhe melodive popullore ruso-letoneze.

Carl Orff



Carl Orff (1895–1982) ishte një kompozitor dhe edukator gjerman. Takimin e parë me muzikën e pati në familje pranë nënës së talentuar pianiste, por në rininë e hershme braktisi praktikat standarde kompozicionale për të eksploruar muzikën në aspektin multimedial, ose më saktësisht afërsinë primitive me ritmin, kërcimin, fizikun, aktivitetin shëndetësor, teatrin, edukimin dhe argëtimin. Ai njihet për fillimin e programit *Orff Schulwerk* dhe hapjen e një shkolle të mesme për punën me fëmijët, duke dashur të fokusohet në ritmin dhe muzikalitetin e tyre natyror, të ngjashëm me atë të njeriut parahistorik në sinkretizëm. Prandaj, në kuadër të këtij programi ai përdori të ashtuquajturat instrumente orf, të cilat zakonisht janë me goditje dhe të lehta për t'u zotëruar. Ato ndahen në ritmike dhe melodike, dhe përfshijnë ksilofon, marimba, metalofon, trekëndësh, kambana, shkopinj, çembale, perkusion, flaut blloku e të tjera.

Nga pikëpamja kompozicionale ai përdorte melodi, ritme dhe harmoni të thjeshta e dinamike, shpesh me shoqërim skenik dhe teatralitet masiv. Vepra e tij më e njohur është kantata "Karmina Burana", pjesa e parë e trilogjisë së kantatave "Triumfet", e bazuar në tekste latine. Pjesët e tjetra janë "Karmina Katuli" dhe "Triumfi i Afërditës".





“Karmina Burana” është një fenomen skenik, modern, i fortë dhe sensual, e ashtuquajturi “Oda e jetës”, ideja e së cilës është se sado të ndryshojnë kohët, raca njerëzore për të kënaqur dëshirat mbetet. Kjo vepër është kantata më e famshme skenike në shekullin e XX-të dhe është një nga kompozimet e interpretuara më shpesh në mbarë botën. Orf punoi në të nga viti 1935 deri në 1936, pasi gjeti një dorëshkrim të harruar, Kodeksin e Stuhisë, një vit më parë në një dyqan antike, i cili në fakt ishte një koleksion vargjesh të shekullit të XIII-të të zbuluar në një manastir pranë Mynihut. Magjepsja e Orfit me këtë tekst, mund të thuhet, pasqyrohet edhe në magjepsjen e kulturës bashkëkohore me veprën e Orfit, e cila njihet ndër të gjithë brezat dhe përdoret si sfond muzikor për të gjitha llojet e ngjarjeve, nga opera e deri te reklamat.

Vepra është shkruar për tre solistë vokalë (soprano, tenor dhe bariton), një kor të madh të përzier dhe një orkestër simfonike, të pasuruar me instrumente me goditje. Ai përbëhet nga 24 tekste interesante, me vargje të shkruara nga murgj, filozofë, studentë, këngëtarë mesjetarë e të ngjashme. Flet për dashurinë, natyrën, magjinë dhe misterin. Është shkruar si vepër skenike, por shpesh interpretohet në mënyrë statike. Kur Orff botoi këtë vepër, ai deklaroi: “Çdo punë e imja e botuar mund të harrohet lirisht. Opusi im fillon me “Karmina Burana”. Prezantimi i “Karmina Burana”, “O Fortuna”, është një performancë e fuqishme korale, në të cilën këndohet për lumturinë e çuditshme dhe të ndryshueshme, rrota e së cilës rrotullohet vazhdimisht.

O, fat
si hëna
ti je i ndryshueshëm,
ndonjeherë e madhe,
ndonjëherë e dobët,
jeta mizore
së pari të mërzit
pastaj të ngushllon
siç i vjen
Varfëria
dhe pushteti
i shkrin si akulli
dhe e zbazët,
ti rrotë e çmendur,
ti je perfide,
prosperiteti është një
gjenjeshtër
dhe gjithmonë zhdukët
në asgjë, në hije

dhe e fshehur
edhe ti me ndjek mua.
Dhe në këtë lojë,
unë i jap asaj shpinën time të
zhveshur
të mizorisë tënde.
Fati është kundër meje
në shëndet
dhe virtyt,
e udhëzuar,
dhe e rënduar
gjithmonë e robëruar.
Prandaj në këtë orë
pa vonese
tërhiq telat,
sepse Fat
shtyp njeriun e fortë,
të gjithë qani me mua!

Test njohurish:

1. Çfarë është dodekafonia?
2. Krahasoni punën e Igor Stravinsky dhe Karl Orf!

Dëgjimi i muzikës (fragmente):

- Igor Stravinski - fragment nga baleti “Dedikim pranverës”
Karl Orf - “O Fortuna”, fragment nga kantata “Karmina Burana”

MUZIKANËT E PARË NË MAQEDONI

Në periudhën ndërmjet shekullit IX dhe XIX, u shfaqën muzikantët e parë në këto troje. Në të njëjtën kohë, u krijua një përzierje ndikimesh të ndryshme, të cilat ndihmuan në formimin e ndjeshmërisë së tyre origjinale, por edhe të përgjithshme folklorike të këtij nënqelli. Nëse trashëgimitë e melodive të lashta, indigjene merren si të dhëna, dhe ato pasohen nga dominimi kulturor i Perandorisë Bizantine, do të arrihet në përfundimin se në mesjetë lloji më i zakonshëm i muzikës ishte muzika kishtare, ortodokse. Mirëpo, kontributet indigjene, bizantine dhe të krishtera për kulturën, e rrjedhimisht edhe për muzikën, nuk janë bazë e mjaftueshme për analizën e veprave të asaj kohe, sepse ato janë ndikuar nga sllavët e vendosur, por edhe nga sundimi i gjatë i Perandoria Osmane. Shën. Qirili dhe Metodi, por dhe Shën. Klimenti dhe Naumi i Ohrit edukuan popullin, por në të njëjtën kohë i trajnuan priftërinjtë për këngën kishtare. Ndikimet orientale, lindore, si dhe veriore pagane vazhduan të pasurojnë teksturën e melosit popullorë. Kështu u zhvillua jo vetëm folklori muzikor që krijoj në vazhdimësi gjeniu popullor, por u krijuan edhe veprat cilësore të kompozitorëve në fusha të ndryshme muzikore.




Jan Kukuzeli (Maq:Jovan Kukuzel, greqisht: Ioannis Koukouzelis)



Jan Kukuzel është një shenjtorë dhe këngëtarë kompozitor i kishës bizantin, i cili besohet se ka jetuar midis shekujve XIII dhe XIV dhe njihet si një reformator i rëndësishëm i muzikës në këto zona. Nuk ka të dhëna specifike për kohën në të cilën ai ka jetuar, si dhe vendndodhjen e saktë të lindjes së tij, megjithëse besohet se e kishte origjinën nga Durrësi (Durrësi i sotëm në Shqipëri) ose nga rajoni i Dibrës. Ai ndoqi një shkollë kënge në Kostandinopojë dhe ishte i preferuar i perandorit. Ai shquhej për aftësitë e tij të bucura vokale, dhe thuhej se kishte një "zë engjëllor". Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në malin Athos si murg. Është interesante se emri i tij, Kukuzel, i referohet ushqimeve të tij të preferuara, kuku / kukija dhe zelje / zelija (greqisht: fasule me lakër). Është i rëndësishëm përsosmërinë e këndimit kishtar dhe i atribuohet edhe krijimit të shënimit neobizantin Kukuzel, i cili gjendet në dorëshkrimet e shekullit XV deri në shekullin XIX. Pak nga veprat e tij janë ruajtur dhe më e famshmja prej tyre është teksti mësimor për këngëtarë "Iso i madh i këndimit Papadic", një lloj solfezhi, i cili karakterizohet nga melodja e gjerë, stolitë e pasura dhe nuancat dinamike të theksuara.

Naum Milladinov - Milladin




Naum Milladinov - Milladin (1817–1895) është vëllai i Dimitria dhe Konstantin Milladinovit, i lindur në Strugë ku kreu shkollën fillore. Më vonë ai shkoi në Durrës, Shqipëri, ku mësoi të luante violinë dhe më pas shkoi në Kostandinopojë, ku studioi në Akademinë Teologjike në Universitetin Halki. Ai u diplomua në degën e muzikës dhe gramatikës. Vitet e fundit të jetës i kaloi në Bullgari. Është autor i një manuali për këndimin noto kishtar, mbledhës i këngëve popullore dhe regjistrimi i tyre me shënim (melograf), pedagog muzikor dhe themelues i muzikologjisë.


- **Melografi** – shkrimi i një melodie popullore në bllok shënimesh me nota.

Në të kaluarën është regjistruar me vesh, ndera në kohën më të re me ndihmën e materialeve të incizuara. Kishte shumë mbledhës të këngëve popullore dhe regjistrues të tyre dhe falë tyre janë ruajtur shumë këngë të krijuara në të kaluarën.

Bisedë për muzikën në Maqedoni në fund të shekullit të XIX-të me integrim përmes poezisë popullore dhe historisë



Atanas Badev



Atanas Badev (1860–1908) është një kompozitor maqedonas, dirigjent kori dhe teoricien i muzikës. Fëmijërinë e kaloi në qytetin e tij të lindjes në Prilep, por talenti që posedonte dhe dëshira për shkollim në shumë fusha e bëri që të udhëtonte shpesh, të studionte në shumë vende të Rusisë dhe të ndërronte vende të punës.

Ndonëse fillimi i studiuar për matematikë dhe fizikë, megjithatë ka vendosur t'i përkushtohet muzikës. Ai hulumtoi dhe grumbulloi këngë popullore maqedonase, ishte mësues muzike, dirigjent kori dhe si kompozitori i parë i arsimuar dhe një nga teoricienët e parë, ai punoi në studimin e ritmeve të përziera metro-ritmike karakteristike për folklorin në Maqedoni - 9/8 tak (3 + 2 + 2) 9/8 (3 + 2 + 2 + 2) dhe 11/8 tak (3 + 2 + 2 + 2 + 2).

Ai ka kompozuar kryesisht vepra vokale me përbajtje shpirtërore dhe shenjtore, por, përfat të keq, i është ruajtur vetëm një fletore për këndim kishtarë dhe vepra e tij më e njohur "Liturgjia e Krizostomit", e cila konsiderohet si vepër e krijuar nga një krijues i talentuar, një mjeshtër i madh i rrrokjes korale, e shkruar me notacion modern, nën ndikimin harmonik të muzikës shpirtërore ruse dhe melodisë maqedonase. Në vendin tonë u shfaq për herë të parë në vitin 1988 dhe është një nga veprat që interpretohen më së shpeshti.

ХВАЛИТЕ ГОСПОДА СНЕБЕС

Атанас Бадев

The musical score consists of four staves for Soprano, Alto, Tenor, and Bass. The tempo is Adagio. The lyrics are written below each staff: 'Хва - ли - те, хва - ли -' for Soprano, 'Хва - ли -' for Alto, 'Хва - ли -' for Tenor, and 'Хва - ли - те, хва - ли -' for Bass. The music is in common time with a key signature of one sharp.

- **Liturgjia** – shërbimi publik, adhurimi kryesorë i krishterë. Teksti këndohet nga një prift në mënyrë recitative, i shoqëruar nga kori "*a cappella*". Kompozitorë të njohur të liturgjive janë: P. I. Çajkovski, P. Çesnokov, A. Badev, S. Rahmajinov, S. Mokranjac, A. Arkhangelski, Fan S. Noli, D. Bortnjanski, etj.

Bisera

Bisera vashë, Bisera
Çfar margaritari mban rrëth
fytit?
Fyti yt i bukur
Dhe nga margaritari i vogël
Një mijë herë më i bardhë

Bisera vashë, Bisera
Pse me margaritarë e mbulon
Fytin tënd të bukur?
Unë nuk dua ta puth margaritarin
Por fytin tënd.

Bisera vashë, Bisera
Për kë i numëron margaritarët?
Për kë pregadit dhuratat?
Unë nuk dua dhuratë margaritarin
Por vashën Biserën!



Fyelli

Që kur isha i vogël,
Nga kalliri bëra një fyell.
Atij i fryja, kërceja
Dhe në ledina të jeshile
Vrapoja pas fluturave.
Deri sa arritën kohëra tjera;
T'i biej fyellit m'a kishte
ëndja.
Me gjëzim bëja ahengje
Dhe me shokët e mi
Lauja me gjith zemër
Vrapoja në lëdina të gjëra
Dhe kaloja liqene.
Tani janë kohëra tjera;

Tani nuk dua të vrapij,
Nuk më pëlqen të shetis,
As që dua të loz me shokë.
Tani ajo që dua më së shumti,
Të kem shoqëri me fyellin,
T'a gjej një vend lartë,
Nën një hije të ftohtë:
para meje një fushë e gjërë
nën këmbë të rrjedh lumi,
mbi kokë era të frys
Dhe unë i mbështetur në
bredh,
T'i bie fyellit
Ashtu si të m'a thotë zemra.



Test i njohurive:

1. Dëgjoni dhe analizoni kompozimin koral “Bisera” (1970) të kompozitorit Stojçe Toshevski!
2. Bëj një krahasim mes këngëve “Fyelli” dhe “Malli për jug” të Konstantin Miladinovit!
3. Të analizohen shembuj nga kombësi të tjera që jetojnë në RSM!


MUZIKA NË MAQEDONI NË SHEKULLIN XX DHE XXI

Në fillim të shekullit XX, përkundër ndryshimeve dhe kushteve të ndryshueshme shoqërore, luftërave dhe ndarjes së territorit tonë, artistët nuk ndalën së krijuari. Filluan të shfaqen Shoqëritë muzikore, në kuadër të së cilave ansamblet e korit po bëhen më të spikatura, duke u formuar në qytete më të mëdha dhe shpesh duke marrë pjesë në festivale folklorike. Karakteri amator i këtyre shoqatave filloi të përmirësohej shpejt me ndihmën e disa muzikantëve profesionistë rusë dhe serbë, të cilët organizonin koncerthe simfonike dhe ngjarje të ngjashme, kështu që kultura muzikore, paralelisht me atë të arteve të tjera, filloi të forcohej.


Shfaqen kompozitorët e parë profesionistë maqedonas. Disa prej tyre janë koleksionistë të artit populor, dhe disa janë të ndikuar nga kultura e Evropës Perëndimore. Ata e marrin arsimin e lartë jashtë vendit, në akademi dhe fakultete të muzikës, të cilat në atë kohë ishin institucione që na mungonin në vendin tonë. Të ndarë në disa breza, veprimtarë, pedagogë të shquar të muzikës, të gjithë me ambicie të mëdha, kanë filluar të marrin hov, kështu që gjatë shekullit të XX kultura muzikore e kësaj treve formohet dhe zhvillohet me sukses.

Kompozitorë maqedonas të lindur deri në mesin e shekullit XX janë: Stefan Gajdov, Zhivko Firfov, Todor Skalovski, Trajko Prokopiev, Petre Bogdanov - Koçko, Gligor Smokvarski, Kiril Makedonski, Vlastimir Nikolovski, Dragoslav Ortakov, Toma Prosakovski, Draban Dragan - Spiravski, Tomislav Zografski, Aleksandar Lekovski, Sotir Golabovski, Jane Kodzabasija, Risto Avramovski, Stojan Stojkov, Stojçe Tosevski, Ilija Pejovski, Tome Mançev e të tjerë. Nga kompozitorët më të rëndësishëm shqiptarë të lindur në vend më i dalluari ishte Lorenc Antoni.

Figura të shquara në shekullin e njëzetë nga artet e tjera



Koço Racin
(poet)



Venko Andonovski
(shkrimtar)



Venko Andonovski
(piktör)



Luan Starova
(shkrimtar)

Todor Skalovski



Todor Skalovski (1909–2004) është kompozitor, dirigjent kori dhe orkestre dhe publicist muzikor, i lindur në Tetovë. Ai studioi në Beograd dhe Salzburg, dhe më pas punoi në disa vende si mësues muzike dhe dirigjent i koreve dhe orkestrave shkolllore, deri në vitin 1948, kur u bë drejtori i parë i Operës së Shkupit. Kryetar shumëvjeçar i Shoqatës së Artistëve të Muzikës dhe Drejtor i Filarmonisë së Maqedonisë janë vetëm disa nga funksionet e tij, ndërsa ka marrë çmime, mirënjoyje dhe dekorata të shumta për arritje jetësore, ndër të cilat edhe "Urdhri i Punës".

Puna e tij krijuese është e larmishme dhe përfshin 114 vepra. Krahas atyre për ansamblet e mëdha dhe përbajtjeve kamertale, veprat vokalo-instrumentale, muzikën për shfaqje dhe suitën e baletit "Baltepe", ai u dallua edhe me kompozime vokale, korale. Ai më së shpeshti frymëzohej nga folklori maqedonas, sic është rasti me veprën e tij më të njohur "Vallja maqedonase", shkruar për një kor të përzier.

"Vallja maqedonase", 1943, përdor vallen e famshme "Teshkoto" si bazë mbi të cilën ndërton strukturën dhe idetë e veta. Ai interpretohet në të gjithë botën dhe konsiderohet si një "dramë e vogël muzikore", e cila është emocionuese, me mjeshtëri ndërthur disa elemente muzikore dhe është deklaratë dhe shprehje e qenies kombëtare.

Makedonsko Oro

Todor Skalovski

Tempo ad libitum

The musical score for "Makedonsko Oro" by Todor Skalovski is presented in two systems of musical staves. The top system includes parts for Soprano, Alto, Tenor, and Bass, along with a Bassoon part. The bottom system includes parts for Bassoon (B.A.), Trombone (T), and Bassoon (B). The score is marked with "Tempo ad libitum" and includes dynamic markings such as *f* (fortissimo) and *p* (pianissimo). Performance instructions like "Ej!" (exhale) and "Ai" (ah) are also present. The music is set in common time with a key signature of one sharp.

Trajko Prokopiev

Trajko Prokopiev (1909–1979) është kompozitor, violinist, dirigjent dhe pedagog maqedonas. Nga vendlindja e tij Kumanova në fëmijërinë e hershme u shpërngul në Shkup me prindërit e tij, ku i kënaqur me mësimet e muzikës në gjimnaz vendosi të shkojë në Beograd dhe disa vite më vonë të përsosej në Pragë. Pas luftës u angazhua në përtëritjen dhe zhvillimin e muzikës në vendlindje, duke kryer disa funksione përgjegjëse: Drejtor i shkollës së muzikës në Shkup, Drejtor i SHKA "Tanec", dirigjent i Filharmonisë, Operës etj. Është fitues i çmimit prestigjioz AVNOJ për kontributin e tij në kinematografinë maqedonase. Megjithëse ishte një dirigjent i shkëlqyer, fokusi kryesor i Prokopiev mbeti në punën e tij. Ai kompozoi kompozime korale, orkestrale, kamertale, muzikore dhe skenike, ku përfshihen operat e tij "Ndarja" dhe "Kuzman Kapidan", si dhe dramë dhe muzikë filmi.



"Labini dhe Dojrana" është vepra e tij e vetme muzikore-skenike, baleti, e cila konsiderohet si baleti i dytë maqedonas i vënë në skenë pas "Histori maqedonase" të Gligor Smokvarshit dhe baletit të parë të kompozuar gjithë natën. Premiera ishte më 11 qershor të vitit 1958 nën dirigjenten e autorit. Veptra karakterizohet nga motive popullore dhe kombinime ritmike, të ngjyrosura në mënyrë romantike. Për nga përbajtja flet për dashurinë e pamundur mes djalit Labin dhe zanës Dojrana, e cila si në legjendë përfundon në mënyrë tragjike. Është interesante se Prokopiev krijoi dy suita baleti për një performancë koncertale nga këngët më të bukura dhe suita e vogël "Dojranka".



Labini dhe Dojranën

Kiril Makedonski



Kiril Makedonski (1925–1984) ishte një talent muzikor, i cili në fëmijërinë e tij, në Manastir, mësoi të luajë në violinë dhe më vonë mori rrugën për në Akademinë e Muzikës në Zagreb, në departamentin e kompozicionit dhe dirigjimit. Magjistraturën për kompozicion e kreu në Lubjanë dhe e përsosi në Poloni dhe Gjermani. Ndryshe nga kompozitorët e tjera, ai ka punuar edhe në fushën e muzikoterapisë, për të cilën ka marrë çmime të shumta jashtë vendit. Ai ka krijuar mbi 30 tekste, referate dhe vepra muzikore për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme, dhe vepra e tij muzikore përfshin muzikë simfonike, 3 opera duke përfshirë operën e parë maqedonase "Goce", opereta, vepra vokalo-instrumentale dhe korale, sonata për instrumente të ndryshme, muzikë filmi dhe drame etj.

Në një rast Makedonski ka thënë: "... Folklori ynë është një klimë natyrore në të cilën jam lindur dhe rritur. Folklori muzikor është një kapital shpirtëror për ne. "Ne mbartim brenda vetes dramën dhe tekstin që janë në thelb të së njëjtës substancë muzikore dhe që i japin veprës sonë individualitet".

Vepra më madhore e K. Makenoskit është opera "Mbreti Samuel", e shkruar nga viti 1962 deri në vitin 1966 me libretin e tij. Premiera e operës u shfaq në Shkup më 5 nëntor 1968. Është një opera në 4 akte dhe një epilog. Idenë për krijimin e tij e ka pasur shumë kohë më parë dhe mbulon periudhën e viteve të pjesërisë së Samuelit. Në qendër të betejave të tij të fundit, intrigat që ndodhën në oborrin e tij dhe tradhtia, e cila përfundoi me fitoren ushtarake të perandorit bizantin Vasili II-të. Kulmi i veprës tregon pritën dhe verbimin e ushtarëve të Samuelit dhe, në fund, vdekjen e tij.



Skena nga opera "Mbreti Samoil"

KORI

është një ansambël vokal i përbërë nga një grup më i madh këngëtarësh që interpretojnë disa kompozime vokale me ose pa shoqërim instrumental

sipas zërave	homogjen	të përzier			
sipas moshës	fëmijëror	rinor	të rritur		
sipas vokacionit profesionit	profesional	amator	shkollor		
sipas numrit	kamertal	mesatar	masiv		
sipas qëllimit	operik	filharmonik	radioteleviziv	qytetar	kishtar

- **Muzika e korit** – muzikë e interpretuar nga një nga ansamblet vokale, e drejtuar nga një dirigjent. Kori miks përbëhet nga katër zëra bazë: soprano, alto, tenor dhe bas.



Kompozitorë të tjera të rëndësishëm maqedonas të lindur në gjysmën e dytë të shekullit XX janë: Dimitrije Buzharovski, Zhivojin Glishiq, Goce Kolarovski, Vanja Nikolovski, Goran Naçevski, Jana Andreevska, Nikola Koxhabashija, Pande Shahov, Valentina Velkovska Trajanovska, Soni Petrovski, Darija Andovski e të tjera.



Dimitrije Buzharovski



Zivojin Glisic



Valentina Velkovska
Trajanovska



Darija Andovska

Vulnet Tairi

Vulnet Tairi (1982) u lind në Gostivar dhe arsimin muzikor e mori në Fakultetin e Muzikës në Shkup, në klasën e profesorëve dhe kompozitorëve Goce Kolarovski dhe Tome Mançev. Krahas punës, Tairi fokusohet edhe në pedagogjinë muzikore, ku për një kohë të shkurtër nga mësues në shkollën fillore të muzikës në vendlindje, u bë profesor i orkestritit në Fakultetin e Muzikës në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Në vitin 2009, Tairi kompozoi *Simfoninë nr. I*, të realizuar nga Filarmonia e Maqedonisë, ndërsa albumi i tij i parë, me titull "Nga opusi i kompozitorit", përbante muzikë kamertale, vokale dhe simfonike. Veprat e tij paraqesin avangardën e jetës moderne. Nga puna e tij e deritanishme, cikli i këngëve solo nr. 2 për zë dhe piano, trio për obo, klarinetë dhe fagot dhe katër pjesë për quintet fymorë, për të cilat ka fituar disa çmime. Puna e tij është e njobur në skenën evropiane dhe në Shtetet e Bashkuara.



Fatos Lumani



Fatos Lumani (1983) ka lindur në Strugë. Shkollimin e mesëm muzikor e kreu në Tetovë, u diplomua në degën e kompozicionit dhe magjistroi në degën e muzikologjisë në Universitetin e Tiranës. Fillimisht ka punuar si asistent në të njëjtin institucion, ndërsa në vitin 2009. të bëhet profesor i analizës harmonike dhe formave muzikore në Fakultetin e Muzikës në Tetovë.

Pothuajse gjysma e veprave të tij janë shkruar për orkestër (simfonike ose kamertale). Folklori është i pranishëm edhe në veprën e tij si pikënisje për trajtimin e mëtejshëm kompozicional. Prezanton teknika të ndryshme kompozicionale duke bërë një përzierje stilesh të shumta, kontraste të thella, përdorimin e dy ose më shumë strukturave ritmike në të njëjtën kohë, etj. Puna e tij përfshin vepra orkestrale, koncerте, simfoni dhe simfoni, sonata, variacione

për katër piano, suita, muzikë filmi etj., të cilat janë interpretuar nga artistë vendas dhe të huaj në disa festivalë dhe gara, ku ka marrë çmime prestigjioze. Është autor i operës së parë shqiptare në RMV - "Skënderbeu", premiera e së cilës u mbajt në sallën e Operës dhe Baletit Kombëtar në Shkup më 23.12.2019.

Dëgjim i muzikës:

Todor Skalovski - "Vallja maqedonase"

Trajko Prokopiev - baleti "Labini dhe Dojrana", fragmente

Kiril Makedonski - opera "Car Samoil", fragmente

Vulnet Tairi - "Katër pjesë" për quintetin fymor

Fatos Lumani - fragmente nga koncerti për piano dhe orkestër (2013)

ZHANRET DHE INSTRUMENTET POPULLORE NË SHEKULLIT XX DHE XXI

Muzika popullore është një fenomen interesant - nuk mund të klasifikohet në mënyrë periodike, sepse ka ekzistuar gjithmonë, dhe nuk mund të klasifikohet për nga përbajtja, sepse përbajtja e saj ndryshon si në hapësirë ashtu edhe në kohë. Është e paqëllimshme, ose më mirë, qëllimi i saj i vetëm është të argëtojë dëgjuesit. Edhe pse, veçanërisht në të kaluarën, muzika popullore i përgjigjej deri diku këtij pëershkrimi, sipas disa studiuesve, muzika popullore nuk përfshin këngë tërësisht popullore (edhe pse përfshin këngë me elementë etno të futur) dhe dikur i përkiste kategorisë së salloneve. Muzikë elitare, e cila nuk ishte menduar për lloje të veçanta ngjarjesh. Sipas kësaj, shumë kompozime që tani konsiderohen klasike ishin argëtuese në atë kohë. Muzika popullore shpesh kërcehet dhe njerëzit pushojnë, dhe melodia e saj është e thjeshtë, lozonjare dhe e lehtë për t'u mbajtur mend, kështu që grupe më të mëdha njerëzish mund ta shijojnë atë.



Zoran Maxhirov

Muzika popullore si e tillë filloi të shquhet veçanërisht në shekullin e njëzetë, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, kur filluan të formohen gjithnjë e më shumë nënloje të zhanreve muzikore, të cilat gjithnjë e më shumë komercializoheshin dhe synoheshin, kryesisht, për audiencën e re.

Mund të thuhet se këto nënzhane popullore janë përgjigja e duhur ndaj zhanreve avangarde, eksperimentale, të cilat po shfaqen paralelisht në këtë periudhë. Natyrisht, ashtu si teknologjia e përparuar ndikoi në stilet e reja të muzikës moderne, po ashtu ndikoi edhe argëtimi. Me kalimin e kohës, ato janë bërë më të pranuara në mbarë botën. Në kombinim me prezantimin e tyre multimedial, gjegjësisht duke u bashkuar me imazhin – përmes fotografisë, televizionit, filmit, radios dhe ngjarjeve gjithnjë e më masive koncertale, ata arritën të krijojnë një kategori të re kulturore.

Njihet në të ashtuquajturat një “kult” ndaj yllit populor, apo, aq më tepër, në krijimin e nënkuulturave të shumta, pra komuniteteve më të vogla brenda një shoqërie më të gjerë, të cilat veç të tjera mund të grupohen dhe njihen sipas shijes së tyre muzikore. Këtu shihet qartë roli i muzikës në procesin e krijimit dhe zhvillimit të një shoqërie. Rockers, punks, metalheads, repers dhe të ngjashme, shpesh nënkuatura rimore, mbrojnë rregulla të veçanta të sjelljes, veshjes, të folurit dhe të jetesës si rezultat i muzikës që ata dëgjojnë. Mund të thuhet se nënkuulturat nuk janë vetëm përcaktues të identitetit në një shoqëri, por edhe pasqyrim i multimedias muzikore në jetën e njeriut.

XHAZI DHE BLUZI

Xhazi dhe bluzi janë stile muzikore që kanë origjinën në fund të shekullit të 19-të në Nju Orleans, Amerikën e Jugut. Të dy stilet mbështeten në meloditë popullore afrikano-amerikane, ku bluzi është një stil dhe zhanër muzikor që rrjedh nga këngët e kënduara nga afrikano-amerikanët gjatë punës në fusha. Bluzi ka një përbajtje pikëlluese, ritmi muzikor është i ngadaltë dhe karakterizohet nga prania e disa uljeve, të ashtuquajturat "blu nota". Xhazi, nga ana tjetër, është një stil muzikor që është i vështirë për t'u përcaktuar sepse përfshin një gamë shumë më të gjerë të nënlojeve muzikore dhe karakterizohet nga përzierja e melodive afrikane dhe evropiane dhe adoptimi i vazhdueshëm i llojeve të reja të instrumenteve (megjithëse tastierat, goditjet janë më të zakonshmet), instrumentet frymore, si dhe kontrabas me tela).

Ndryshe nga bluzi, ku performance vokale dhe rrëfimi janë në plan të parë, në xhaz instrumentet janë qendrore dhe aftësitë e instrumentistëve dalin në pah. Në fakt, improvizimet janë më të rëndësishme se notat e shkruara, kështu që interpretuesi është më i rëndësishëm se kompozitori. Ai është i mbushur me sinkopë, "nota blu" dhe mbizotërim të ritmeve specifike. Nëntipet e këtyre stileve janë: bi-bap, hot xhaz, kul xhaz, xhaz avangarde, fri xhaz, xhaz progresiv, midël-xhaz, sving-stil, bugi-vugi, diksiland-stil, çikago-stil etj.



Louis "Satchmo" Armstrong



Ella Fitzgerald



Simon Kiselićki



Toni Kitanovski



Bobi Serafimovski

Përfaqësuesit më të njohur të xhazit dhe bluzit janë: Louis "Satchmo" Armstrong, Nina Simone, Rej Çarls, Beni Gudman, Djuk Ellington, Glen Miler, B. B. King, Ella Ficxherald, Besi Smit, Eta Xhejms, Xhozef "King" Oliver, Xheorxh Gershvin, Çarli Parker, Bili Holidej, Kol Porter, Xhon Koltrejn, Majls Dejvis, Herbi Henkok, Sara Von, Çik Korea dhe të tjerë, ndërsa më të njohur në vendin tonë janë: Dragan Gjakonovski - Shpato, Ilija Pejovski, Toni Kitanovski, Simon Kiselićki, Bobi Serafimovski, Zoran Maxhirov e të tjerë.

ROKENROL / ROK

Zhanër në muzikën popullore, i shfaqur rreth vitit 1940 në Amerikë. Është një kombinim i muzikës bluz, kantri, klasike dhe elektronike. Megjithëse termi "rok" fillimi isht u përdor si shkurtim, me kalimin e kohës ai mori kuptimin më të gjerë të zhanrit, duke përfshirë shumë nën-zhanre, e para prej të cilave, më e vjetra, njihet si rokenroll.

